

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5761
E enjte, 25 prill 2019
çmimi 0.40 €

Ngadhnjim Kastrati edhe zyrtarisht drejtor i përgjithshëm i RTK-së

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

POLITIKA NDAJ PAKICAVE PËRSHPEJTON INTEGRIMIN E SHTETIT NË BE F. 6

Shkruan: Mr. Kristjan DUKAJ

VAKSINIMI, MËNYRA MË E LIRË DHE MË EFIKASE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NGA SËMUNDJET F. 6

GASHI E BERISHA: NDRYSHIMI I KUFIJVE SJELL PËRKEQËSIM TË SITUATËS NË BALLKAN F. 11

EKONOMI



HAPET PANAIRI NDËRKOMBËTAR 'PRISHTINA 2019', BËHET THIRRJE PËR KONSUMIM TË PRODHIMEVE VENDORE F. 9

UJËSJELLËSI DËRGON BORXHLINJTË TE PËRMBARUESIT PRIVATË F. 8

KULTURË

NUK I GJEJ ILAÇ PANDERSHMËRISË SË PUSHTETARËVE F. 16-17

Intervistoi: B. Armagedoni

SPORT

EKIPI I XHUDOS NË KRYE ME MAJLINDA KELMENDIN PËRFAQËSOJNË KOSOVËN NË MINSK 2019 F. 18

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ) NUK KA SIGURUAR DY TË TRETAT E VOTAVE PËR CERTIFIKIMIN E KANDIDATËVE TË LISTËS SERBE PËR ZGJEDHJET QË DO TË MBAHEN NË KOMUNAT VERIORE

Nuk certifikohen kandidatët e Listës

Serbe për zgjedhjet në veri



Abstenimi i dy anëtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) ka pamundësuar certifikimin e katër kandidatëve të Listës Serbe që pritet të garojnë për

kryetarë të komunave veriore të Kosovës në zgjedhjet e jashtëzakonshme të 19 majit. Zyrtarët e LV-së e kanë kundërshtuar rikandidimin e kryetarëve të dorëhequr të komunave veriore,

ndërsa anëtarët e tjetër të KQZ-së dhe njohësit e proceseve zgjedhore e kanë kritikuar abstenimin e anëtarëve të LV-së, duke theksuar se KQZ-së nuk duhet t'i jepet konotacion politik

A pritet ta qartësojë Samiti i Berlinit të ardhmen e dialogut Kosovë - Serbi?

FAQE 3

Njohësi i proceseve politike Belul Beqaj dhe njohësi i integritimeve evropiane Vigan Qorrolli kanë paralajmëruar se Samiti i Berlinit do t'i japë përgjigje çështjes së shkëmbimit të territoreve si dhe do ta qartësojë të ardhmen e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Sipas tyre, ky samit do ta orientojë zgjedhjen e Kosovës brenda kufijve ekzistues. Beqaj dhe Qorrolli kanë kërkuar nga presidenti dhe kryeministri që të flasin me një zë në këtë samit sepse, sipas tyre, kjo do ta forconte pozicionin shtetëror të Kosovës në raport me Serbinë



**Besiana Kadare:
Dhunimet
janë 'po aq
shkatërruese sa
edhe armët e
shkatërrimit
masiv'**

FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666



**ORGANIZATA E VETERANËVE TË LUFTËS
TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS**



TUBIM PËRKUJTIMOR



NJOFTIM

HOMAZHE DHE TUBIM PËRKUJTIMOR

Në tre vjetorin e ndarjes nga ne e veprimtarit
të shquar të Çështjes Kombëtare

SHASIVAR MAKOLLI - QALI

Më 26 prill 2019, në ora 11:00, në Varrezat e Qytetit në Prishtinë,
bëhen homazhe ndërsa në

ora 16:00, në Teatrin Kombëtar në Prishtinë do
të mbahet TUBIM PËRKUJTIMOR

Prezenca juaj nderon kujtimin për ata që i kushtuan
tërë jetën Çështjes Kombëtare Shqiptare

Miratohen ligjet që Ivanovi nuk i dekretoi

SHKUP, 24 PRILL - Kuvendi i Maqedonisë së Veriut ka miratuar 13 ligjet të cilat paraprakisht nuk i ka dekretuar presidenti Gjorge Ivanov. Pasi përfundoi votimi për këto

ligje, kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi, ka kërkuar nga koordinatori i BDI-së, Ejup Alimi, që të mos hapin debatin e paralajmëruar në Propozimligjin për Këshillin

Gjyqësor. Xhaferi ka thënë se vendi ndodhet në fushatë parazgjedhore presidenciale dhe nuk dëshiron të keqpërdoret foltorja e Kuvendit për propagandë politike.



U caktohet masa e arrestit shtëpiak edhe 19 grave të tjera të kthyer nga Siria

PRISHTINË, 24 PRILL - Gjykata Themelore e Prishtinës ka njoftuar se u është caktuar masa e arrestit shtëpiak 19 grave të tjera të kthyer nga Siria. Në njoftimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës thuhet se gjyqtari i procedurës paraprake ka vendosur lidhur me dy kërkesat e Prokurorisë Speciale të Kosovës për caktimin e masës së arrestit shtëpiak kundër të pandehurave R.Q, E.Z, J.XH, A.M, Q.S, E.B, V.A, E.S, M.T, V.T-D, SH.T, M.T, L.I, A.A, G.L-K, D.D, V.I dhe J.L për shkak të veprës penale, bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose para policore, në organizimet grupore apo individualisht jashtë territorit të Republikës së Kosovës. "Të pandehurave R.Q, E.Z, J.XH, A.M, Q.S, E.B, V.A, E.S, M.T, V.T-D, SH.T, M.T, L.I, A.A, G.L-K, D.D, V.I dhe J.L iu është caktuar masa e arrestit shtëpiak në kohëzgjatje prej 1 (një) muajsh për secilën veç e veç, duke filluar nga data 24.04.2019 deri më datë 24.05.2019", thuhet në njoftimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës.

Kimete Krasniqi, avokate e njëjës nga gratë e dyshuara për këtë veprë penale, tha pas seancës, se ka kundërshtuar kërkesën e Prokurorisë për vendosjen e masës së arrestit shtëpiak. "Për të mbrojturën time nuk ka asgjë që është e vërtetuar se ka kryer këtë veprë penale. Klientja ime ka qenë e mashtruar nga burri i saj tashmë i ndjerë, i cili është vrarë pas tre muajsh të qëndrimit atje", tha Krasniqi.

Grupi i parë i përbërë nga dhjetë gra u paraqit të martën para Gjykatës Themelore të Prishtinës. Pas përfundimit të seancës, Gjykata Themelore e Prishtinës njoftoi se ka vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Speciale për caktimin e masës së arrestit shtëpiak kundër 10 grave të pandehura, me inicialet V.B., F.D., F.L., N.H., A.Z., V.K., H.K., L.L., S.S. dhe M.A. për shkak të veprës penale bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose para policore, në organizimet grupore apo individualisht jashtë territorit të Republikës së Kosovës. Të dhjetë grave iu caktua masa e



arrestit shtëpiak në kohëzgjatje prej 1 muajsh për secilën, duke filluar nga data 23.04.2019 deri më 23.05.2019. Gjykata tha se ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurat që nga viti 2014 e deri më 20.04.2019 kanë qenë në zonën e konfliktit në Siri dhe Irak.

Prokurori Special Sylë Hoxha

konfirmoi të martën për "Radion Evropa e Lirë" se janë duke u zhvilluar hetime ndaj 32 grave të kthyer nga Siria nën dyshimet për veprën penale, bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose parapolicore jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

Javën e kaluar, 110 kosovarë u kthyen nga Siria në Kosovë, kryesisht gra dhe fëmijë, mirëpo edhe katër luftëtarë të cilët u arrestuan menjëherë pas arritjes në Kosovë. Të kthyerit u mbajtën për 72 orë në Qendrën për të Huajt në fshatin Vranidoll në periferi të Prishtinës dhe më pas u lejua që të rikthehen në shtëpitë e tyre.

9 000 maturantë në Shqipëri duan të ikin jashtë vendit



TIRANË, 24 PRILL - Kërkesa e shqiptarëve për të studiuar jashtë vendit është në rritje. Nga të dhënat paraprake të Ministrisë së Arsimit rreth 9 000 maturantë kanë deklaruar në formularin A1, se kanë nisur procedurat e njehsimit të diplomave. Ndërkohë që kjo shifër pritet të jetë më e lartë, pasi ky proces

mbyllet në shtator. Shqipëria renditet e para në rajon për numër më të lartë të studentëve që zgjedhin për të studiuar jashtë në raport me numrin e banorëve. Sipas të dhënave të Institutit të Statistikave të UNESCO-s, vitin që shkoi 17 397 të rinj shqiptarë studiuan jashtë vendit, prej tyre mbi 10 mijë

vetëm në Itali. Ndërsa destinacioni i dytë është Greqia me 1 633. Në këto dy shtete janë të përqendruar rreth 80 për qind të studentëve shqiptarë jashtë. Largimi i të rinjve është një alarm pasi, fatkeqësisht, pjesa më e madhe e tyre nuk rikthehen më në Shqipëri për ta dhënë përvojën e fituar në universitetet jashtë vendit.

Negociatat me opozitën, ndryshon formula për reformën zgjedhore

TIRANË, 24 PRILL - Partia Socialiste në Shqipëri dhe opozita në parlament kanë ndryshuar formulën e Komisionit të Reformës Zgjedhore. Këto ndryshime vijnë pas diskutimeve mes grupeve parlamentare.

Komisioni do të përbëhet nga dhjetë anëtarë, ku pjesë e saj do të jenë edhe katër anëtarë të opozitës së re. Anëtarët e Komisionit të Reformës Zgjedhore nga PS-ja do të jenë Damian Gjijnuri, Blerina Gjylameti,

Bashkim Fino, Klotilda Ferhati dhe Alket Hyseni. Ndërsa anëtarët e Komisionit të Reformës Zgjedhore nga opozita e re do të jenë Rudina Hajdari, Andi Përmeti, Ralf Gjoni, Nimet Musaj.



Kosova optimiste se mund të ketë lëvizje pozitive nga Samiti i Berlinit që do të mbahet më 29 prill

A pritët ta qartësojë Samiti i Berlinit të ardhmen e dialogut Kosovë - Serbi?

Njohësi i proceseve politike, Belul Beqaj dhe njohësi i integritimeve evropiane, Vigan Qorrolli, kanë paralajmëruar se Samiti i Berlinit do t'i japë përgjigje çështjes së shkëmbimit të territoreve si dhe do ta qartësojë të ardhmen e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Sipas tyre, ky samit do ta orientojë zgjidhjen e Kosovës brenda kufijve ekzistues. Beqaj e Qorrolli kanë kërkuar nga presidenti dhe kryeministri që të flasin me një zë në këtë samit sepse, sipas tyre, kjo do ta forconte pozicionin shtetëror të Kosovës në raport me Serbinë

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 24 PRILL - Takimi i liderëve të Ballkanit Perëndimor që do të mbahet më 29 prill në Berlin është komentuar në mënyra të ndryshme nga analistët politikë, njohësit e integritimeve evropiane si dhe nga deputetët e pozitës dhe të opozitës. Ata kanë shprehur optimizëm se nga ky takim mund të ketë lëvizje pozitive për Kosovën dhe për të ardhmen e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve.

Njohësi i integritimeve evropiane, Vigan Qorrolli, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se samiti i Berlinit do t'i japë një përgjigje çështjes së shkëmbimit të territoreve dhe do t'i kornizojë në masë të madhe negociatat Kosovë - Serbi. Sipas tij, Samiti i Berlinit do të japë lajme të mira edhe për çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën. "Për këtë duhet pritur përfundimi i Samitit të Berlinit i cili do t'i kornizojë në masë të madhe këto negociata dhe një konferencë ndërkombëtare për Kosovën (sipas gjasave do të mbahet në ShBA) pritët të ndodhë së shpejti, aty ku do të nënshkruhet 'paqja e madhe mes dy shteteve'. Në muajin maj do të mbahen zgjedhjet për institucionet e BE-së, ndërsa në vjeshtë është më realiste të presim për një afatizim më të saktë kohor se kur do të ndodhë kjo marrëveshje. Megjithatë, Samiti i Berlinit do të japë lajme të mira edhe për çështjen e vizave për

për zgjidhjen e konflikteve? Sipas tij, kjo do të jetë pyetja kryesore së cilës përgjigje do t'i japin liderët e vendeve të Ballkanit para dyshes Merkel - Macron.

Qorrolli ka vlerësuar se presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj duhet të flasin me një zë në Samitin e Berlinit. Ai ka theksuar se kjo do ta forconte pozicionin shtetëror të Kosovës në raport me Serbinë.

Edhe politologu Belul Beqaj beson se takimi i Berlinit, i cili do të mbahet në fund të këtij muaji, do ta orientojë zgjidhjen definitive të Kosovës brenda kufijve ekzistues ngaqë, sipas tij, pasojat e gabuara dhe pozitive të zgjidhjes do të reflektohen, para së gjithash, në Evropë. "Besoj se takimi i radhës në Berlin do ta përforcojë orientimin se zgjidhja domosdoshmërisht duhet të kërkohet brenda kufijve ekzistues. Pozita dhe opozita e Kosovës duhet të bëhen unike për gjetje të formulës së pranueshme që do t'i

akomodojë serbët brenda kufijve të shtetit të Kosovës. Kosova ka marrë obligime të cilat nuk i ka përmbushur (pavarësisht prej arsytimit) për themelimin e Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe. Liderhipi kosovar duhet të kujdeset edhe për reciprocitet të standardeve meqë zgjidhja për serbët brenda Kosovës duhet të reflektohet me vendosjen e standardeve të drejtave edhe për shqiptarët në Serbi", është shprehur Beqaj për gazetën "Epoka e re".

Edhe deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Nismës Socialdemokrate, Zafir Berisha, ka thënë se nga Samiti i Berlinit pret sqarim të pozicioneve për të ardhmen e Kosovës dhe Serbisë. "Nga Samiti i Berlinit pres të sqarohen pozicionet edhe të organizatorit, por edhe të palëve Kosovë - Serbi rreth të ardhmes të dy vendeve, por edhe të rajonit. Qëndrimet e përfaqësuesve të Kosovës në këtë samit janë tepër të rëndësishme, prandaj mendoj se nuk

duhet të shkohet me dy qëndrime për një materie sepse dalim joseriozë dhe lëmë hapësirë për manovrim të logjikës politike ruso-sllave në rajonin e trazuar të Ballkanit. Kosova duhet të sillet si shtet i pavarur dhe Serbinë duhet ta trajtojë si shtet fqinj, në të kundërtën rrezikojmë të ardhmen e fëmijëve tanë dhe paqen në rajon kur kemi parasysh se në Serbi vazhdon të jetë në krye të institucioneve mentaliteti që në fundshekullin e kaluar ka bërë luftëra të përgjakshme", ka deklaruar Berisha për gazetën "Epoka e re".

Ndërsa zyrtari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Sadri Ferati, ka vlerësuar se takimi i Berlinit përfundimisht nuk do të qartësojë të ardhmen e dialogut por, sipas tij, mund të jetë një nxitje për të sjellë diçka pozitive. "Nuk pres që takimi i Berlinit përfundimisht ta qartësojë të ardhmen e dialogut, megjithatë mund të jetë një nxitje dhe mund të ketë diçka pozitive", është shprehur Ferati për gazetën "Epoka e re".



Dënohen me burg ish-zyrtarët e Ministrisë së Shëndetësisë

PRISHTINË, 24 PRILL - Gjykata Themelore në Prishtinë i ka shpallur fajtorë Ferid Aganin, ish-ministër i Shëndetësisë dhe Gani Shabanin, ish-sekretar i kësaj ministrie, me akuzat për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe përfitimeve të paligjshme lidhur me rastin e njohur si

"Stentat".

Përmes një komunikate për media, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, ka njoftuar se ish-ministri Ferid Agani është dënuar me burg në kohëzgjatje prej dy vjet e gjashtë muaj, ndërsa ish-sekretari Gani Shabani

është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej dy vjetësh. "Gjykata ka vërtetuar se i akuzuari F. A. (Ferid Agani), në cilësinë e ish-ministrit të Shëndetësisë dhe G. Sh. (Gani Shabani), në cilësinë e ish-sekretarit të përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, kishin

keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare me qëllim të sigurimit të përfitimit të kundërligjshëm të dorisë pasurore për vete apo të tjerët", thuhet në komunikatën e Gjykatës.

Ish-ministri Agani dhe ish-sekretari Shabani ishin akuzuar se kanë shkelur Ligjin për Prokurim

Publik dhe Udhëzimet Administrative të Ministrisë së Shëndetësisë dhe kanë lejuar pagesat për trajtimin e pacientëve jashtë institucioneve publike shëndetësore gjatë viteve 2011-2015.

Vendimi i kësaj gjykate mund të dërgohet në Gjykatën e Apelit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) nuk ka siguruar dy të tretat e votave për certifikimin e kandidatëve të Listës Serbe për z

Nuk certifikohen kandidatët e Li



Abstenimi i dy anëtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) ka pamundësuar certifikimin e katër kandidatëve të Listës Serbe që pritet të garojnë për kryetarë të komunave veriore të Kosovës në zgjedhjet e jashtëzakonshme të 19 majit. Zyrtarët e LV-së e kanë kundërshtuar rikandidimin e kryetarëve të dorëhequr të komunave veriore. Ndërsa anëtarët e tjetër të KQZ-së dhe njohësit e proceseve zgjedhore e kanë kritikuar abstenimin e anëtarëve të LV-së, duke theksuar se KQZ-së nuk duhet t'i jepet konotacion politik

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 24 PRILL - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) nuk i ka certifikuar katër kandidatët e subjektit politik, Lista Serbe, që pritet të garojnë për kryetarë të komunave veriore të Kosovës në zgjedhjet e jashtëzakonshme të 19 majit. Kjo pasi, të mërkurën, në mbledhjen e KQZ-së, dy anëtarët e Lëvizjes Vetëvendosje, Nazlie Balaj dhe Adnan Rustemi, kanë abstenuar në këtë proces, duke pamundësuar arritjen e dy të tretave të votave për certifikimin e kandidatëve.

Lëvizja Vetëvendosje ka kundërshtuar rikandidimin e kryetarëve të dorëhequr të komunave veriore meqë në dorëheqjet e tyre kishin përdorur emrin jokushtetues të Kosovës. Anëtarë i KQZ-së nga

Lëvizja Vetëvendosje, Adnan Rustemi, ka deklaruar se Lista Serbe duhet t'i zëvendësojë kandidatët e paraqitur për zgjedhjet e 19 majit. "Unë kam pritur që për këto 24 orë Lista Serbe do t'i zëvendësojë tre nga katër kandidatët të cilët kishin dhënë dorëheqje para pesë muajsh, e që deklaratat e tyre të dorëheqjes, aktet e dorëheqjes në përmbajtje e konsideronin Kosovën pjesë të Serbisë dhe i referoheshin Kosovës si 'Kosovë dhe Metohi'. Unë, po ashtu, kam pritur nga Lista Serbe që të distancohet publikisht nga përmbajtja e këtyre deklaratave. Nëse e ka të pamundur që t'i zëvendësojë (v.j. kandidatët), të paktën le të japë dëshmi që distancohet nga përmbajtja e dorëheqjeve", ka thënë Rustemi.

Këto deklarime të anëtarit të LV-së në KQZ janë kundërshtuar

nga kryetarja e këtij institucioni, Valdete Daka dhe anëtarët e tjerë. Sipas tyre, anëtarët e KQZ-së duhet të distancohen nga deklaratimet politike. E para e KQZ-së, Valdete Daka, ka deklaruar se ky institucion nuk mund të bëjë kushtëzime dhe as vlerësime, duke shtuar se kandidatët i kanë plotësuar kushtet ligjore. "Na nuk jem institucion që bëjmë kushtëzime dhe as që merremi me vlerësimin e vendimeve të presidentit. Secili institucion i ka punët e veta. Kandidatët kanë plotësuar kushtet ligjore me këtë ligj, në bazë të të cilit ne i organizojmë zgjedhjet dhe nuk mund të shkojmë me kërkesa politike", ka thënë Daka.

Të njëjtin qëndrim ka pasur edhe anëtarë i LDK-së në KQZ, Florian Dushi. Sipas tij, anëtarët e këtij institucioni të pavarur duhet ta ruajnë rolin dhe

integritetin e këtij institucioni. "Kjo është përtej autorizimeve tona, për ruajtjen e këtij institucioni me rëndësi dhe peshë ne do të duhet të japim maksimumin përtej qëndrimeve politike, të provojmë ta ruajmë rolin e këtij institucioni duke mos krijuar precedant të rrezikshëm", është shprehur Dushi.

Abstenimi i anëtarëve të LV-së në këtë çështje është kritikuar edhe nga njohësit e proceseve zgjedhore. Blerim Burjani ka thënë për gazetën "Epoka e re" se kësaj çështje nuk duhet t'i jepet konotacion politik. "KQZ-ja si organ teknik profesional nuk duhet të jetë i nxitur nga çështjet politike, aq më pak në situata të tilla kur është e rëndësishme për shtetin tonë dhe kur ka të bëjë me shprehjen e vullnetit të qytetarëve dhe implementimin e tij. Kësaj çështje nuk duhet t'i jepet konotacion politik, por teknik dhe profesional", ka thënë Burjani, duke paralajmëruar se Lëvizja Vetëvendosje edhe në të ardhmen mund të veprojë në këtë mënyrë. "Abstenimi i anëtarëve të LV-së ka qenë politik. Po e përsëris edhe një herë se KQZ-ja nuk guxon për të manifestuar qëndrime politik, sepse ky është institucion teknik profesional

dhe aty nuk ka manifestim politik. Aty ka vetëm kritere ligjore për certifikim dhe jo kritere politike. Mendoj se Vetëvendosje këso telashe do të bëjë edhe në të ardhmen sa herë që nuk i konvenon certifikimi i rezultateve", është shprehur Burjani. Sipas tij, një veprim i tillë është edhe mesazh i keq për Kosovën në syrin e ndërkombëtarëve. "Me qëllim politik po i pamundësohet Listës Serbe për të marrë pjesë në zgjedhje. Kjo është për të marrë përgjegjësi komplet KQZ-ja dhe që shtetit të Kosovës i bie se po pengon zhvillimin e demokracisë dhe po i pengon të drejtat civile demokratike të qytetarëve serbë", ka thënë Burjani.

Ai ka treguar se zgjidhja më e mirë për t'u ikur këtyre problemeve është depolitizimi i këtij institucioni. "Duhet patjetër të shkohet në depolitizim të këtij organi, sepse nuk është problemi pse sot nuk është certifikuar Lista Serbe. Edhe në të ardhmen ky institucion me këtë formulë 2+2+2 që është bërë nga presidenti i vendit e ka bllokuar përfundimisht KQZ-në për faktin se çdo vendim që ka të bëjë me dy të tretat, KQZ-ja do të jetë organ i bllokuar", është shprehur ai.

zgjedhjet që do të mbahen në komunat veriore

Listës Serbe për zgjedhjet në veri



Për shkak të moscertifikimit të këtyre kandidateve çështja tash pritet të kalojë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP).

Kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, ka thënë se në një afat prej 24 orësh subjekti politik Lista Serbe mund të bëjë ankesë në panel. Të katër komunat me shumicë serbe në veri të vendit janë pa kryetarë që nga 27 nëntori i vitit të kaluar, kur ish-kryetarët dhanë

dorëheqje në shenjë proteste ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për të vendosur tarifa prej 100 përqindësh ndaj mallrave serbe. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka shpallur zgjedhjet e jashtëzakonshme për katër komunat veriore të cilat do të mbahen më 19 maj. Në këto zgjedhje Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Demokratike e Kosovës po ashtu do të garojnë me kandidatët e vet.

Vuçiçi reagon për moscertifikimin e kandidatëve të Listës Serbe

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiçi, ka thënë të mërkurën se refuzimi i kandidatëve të Listës Serbe përbën shkelje brutale të demokracisë. "Kemi nënshkruar marrëveshjen e Brukselit dhe në pikën shtatë ose tetë na imponon pjesëmarrjen në zgjedhje sipas ligjeve të Kosovës, ndërsa tani u pengon që Lista Serbe po fiton", ka thënë Vuçiçi para gazetarëve. Ai ka deklaruar se një vendim i tillë është shqetësues, ndërsa ka paralajmëruar se për këtë çështje do ta presë edhe mendimin e zyrtarëve evropianë gjatë takimit në Berlin të Gjermanisë.

Besiana Kadare: Dhunimet janë 'po aq shkatërruese sa edhe armët e shkatërrimit masiv'

"Epoka e re"

PRISHTINË, 24 PRILL - Me rastin e debatit rreth grave, paqes dhe sigurisë të zhvilluar në Seancën E Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të mbajtur më 23 prill 2019, u shtrua çështja e dhunës seksuale gjatë konflikteve. Shumica e 91 personaliteteve që intervenuan në këtë debat bënë apel që të forcohet lufta kundër mosndëshkrimit të krimeve të dhunës seksuale.

Përfaqësuesja e Përhershme e Shqipërisë në Kombet e Bashkuara në Nju Jork, Besiana Kadare, gjatë diskutimit të saj ka theksuar se dhunimet seksuale të kryera gjatë periudhës së konfliktit përbëjnë shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut dhe një sfidë për sigurinë. "Dhunimet janë 'po aq shkatërruese sa edhe armët e shkatërrimit masiv' dhe llogariten ndër krimet më të rënda. Rezoluta historike 1325 (2000) krijoi një kornizë të fortë normative dhe vuri në dukje një paradigme: në të ardhmen dhunimet seksuale në periudha konfliktesh konsiderohen si kërcënim për

paqen dhe sigurinë ndërkom-bëtare. Megjithatë, përkundër vullnetit të madh politik dhe përpjekjeve të ndërmarra, krimet që lidhen me dhunimet seksuale gjatë periudhave të konflikteve nuk janë pakësuar", ka deklaruar Kadare.

Kadare ka nënvizuar "rolin thelbësor që kanë luajtur shoqëria civile dhe organizatat e grave për t'i dokumentuar abuzimet dhe për të ofruar përgjigje adekuate viktimave të këtyre krimeve". Ajo ka përmendur "legjislacionin kombëtar, sidomos përfshirjen e kësaj çështjeje gjatë trajtimeve në fusha të ndryshme civile, të policisë dhe ato ushtarake". Përpos kësaj, Kadare ka ftuar sekretarin e përgjithshëm që në raportin e ardhshëm ta përfshijë rastin e Kosovës ku, sipas saj, "dhunimet që kishin për cak civilët kanë shërbyer si armë lufte, dhe ku 20 000 të mbijetuarat të këtij krimi vazhdojnë të vuajnë nga stigmatizimi".

Ndërsa Mara Marinaki, këshilltare e Bashkimit Evropian për këtë çështje, vuri theksin në përgjegjësinë e të gjitha shteteve dhe të bashkësisë ndërkombëtare në

tërësi që çështjen e dhunës seksuale gjatë konflikteve ta trajtojnë sipas tri parimeve: parandalim, mbrojtje dhe përndjekje në institucionet e drejtësisë. Ajo ka theksuar se BE-ja mbështet të gjitha përpjekjet që kanë për qëllim që t'i japin fund mosndëshkrimit të këtij krimi.

Kur është në pyetje qasja ndaj viktimave të dhunës seksuale, këshilltarja e Bashkimit Evropian nënvizoi shembullin inkurajues të Kosovës, ku të mbijetuarat e këtij lloji të dhunës mund të kërkojnë dëmshpërbllim për traumat që kanë përjetuar gjatë luftës.

Në seancën e pasdites Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara miratoi rezolutën S/RES/2467(2019) kundër dhunës seksuale gjatë konflikteve. Për këtë projektrezolutë votuan 13 vende, ndërsa Rusia dhe Kina abstenuan.

Vlen të përmendet se tekstin e kësaj rezolute e kishte përpiluar Qeveria e Gjermanisë.

Ministri gjerman i Punëve të Jashtme, Heiko Maas, tha: "Fakti që nuk dalin para drejtësisë autorët e dhunës seksuale krijon një mosndëshkrim vrastar".



Ngadhnjim Kastrati edhe zyrtarisht drejtor i përgjithshëm i RTK-së

PRISHTINË, 24 PRILL (ER) - Më 19 prill 2019 Bordi i RTK-së kishte votuar me 6 vota për dhe një kundër për kandidatin Ngadhnjim Kastrati për pozitën

e drejtorit të përgjithshëm. Meqenëse neni 32.3 i Ligjit për RTK-në ishte i paqartë rreth asaj se çfarë konsiderohen 2/3 e votave të anëtarëve për zgjed-

hjen e drejtorit, Bordi i RTK-së kërkoi interpretim ligjor për këtë çështje. Pas marrjes së interpretimit ligjor, i cili e qartëson nenin 32.3 të Ligjit

për RTK-në, Bordi të mërkurën konstatoi se Ngadhnjim Kastrati është zgjedhur drejtor i përgjithshëm për një mandat trevjeçar.



Diskutohet dhënia e prioritetit të ekspertizave forenzike për sistemin prokurorial

EPOKA E

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 PRILL - Kryesuesi i Këshillit Prokurorial (KPK), Bahri Hyseni, ka pritur në takim kryeshefin ekzekutiv të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë (AKF), Blerim Olluri, me të cilin ka biseduar për çështjet e bashkëpunimit të ndërsjellë. Qëllimi i takimit ishte diskutimi i mbështetjes së nevojshme për ofrimin e shërbimeve forenzike me prioritet të lartë dhe në kohë sa më të shpejtë për rastet që lidhen me lëndët e ndryshme penale. Në këtë kontekst, kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, ka kërkuar nga kryeshefi i AKF-së, Blerim Olluri, që të mundësohet dhënia e prioritetit për lëndët me paraburgim dhe lëndët e tjera, në mënyrë që të zbardhen

shpejt hetimet për rastet e ndryshme kriminale. Ndër të tjera, Hyseni dhe Olluri kanë diskutuar edhe për organizimin e takimeve të zyrtarëve të sistemit prokurorial dhe atyre të kësaj agjencie për t'i koordinuar çështjet e përbashkëta, si dhe kanë theksuar nevojën e njohjes së proceseve dhe procedurave të nxjerrjes së ekzaminimeve forenzike përmes organizimit të vizitave të prokurorëve në laboratorët përkatës. Të dy bashkëbiseduesit janë pajtuar që ta mbështesin hartimin e një ligji të veçantë për rregullimin e procedurave të ekspertizave të nevojshme për sistemin e drejtësisë, ligj ky i cili është edhe shtruar si kërkesë imediate nga ana e kryesuesit të Këshillit Prokurorial, Bahri Hyseni, në takimin e tretë të Bordit të Agjencës së Përbashkët



"Drejtësia 2020". Agjencia e Kosovës për Forenzikë lehtëson punën e institucioneve për

arritjen e drejtësisë, duke bërë të mundur që provat materiale të ofrohen pas ekzaminimit për

Prokurorin e Shtetit, gjyqësinë, hetuesinë dhe institucione të tjera të zbatimit të ligjit në Kosovë.

SBASHK-u pjesë e protestës së mësimdhënësve të Evropës në Bruksel

PRISHTINË, 24 PRILL (ER) - Konfederata e Sindikatave Evropiane dhe Komiteti i Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE) organizojnë një protestë më 26 prill në Bruksel në mbrojtje të profesionit dhe të figurës së mësuesit.

Në këtë protestë do të marrin pjesë edhe përfaqësues të SBASHK-ut të cilët do t'i bashkohen zërit të kolegëve të tyre nga e tërë Evropa për autonomi shumë më të madhe profesionale, mbështetje dhe rritje të investimeve në arsim, kushte shumë më të mira pune, për dialog të mirëfilltë social, përfshirje të sindikatave në vendimmarrje, për mbrojtje të profesionit dhe figurës së mësuesit dhe për çështje të tjera nga aktualiteti në arsim. "Kjo protestë do të jetë nisje e aktiviteteve që do të zhvillohen pastaj nga sindikatat anëtare në shtetet e tyre për ta

sensibilizuar opinionin e për të ndikuar te qeveritë dhe institu-

cionet e tjera krijimin e kushteve për edukimin sa më cilësor për

të gjithë, për rritjen e buxhetit për arsim dhe për forcimin e

dialogut social. Një aktivitet i vazhdueshëm në të gjitha shtetet e Evropës do të jetë insistimi që sindikatat kudo që janë të merren vendime për arsimin e jo t'u shërbehen vendime e të kërkohet implementimi i tyre pa vullnetin e punëtorëve të arsimit", është thënë në njoftimin e SBASHK-ut.

Përfaqësuesit e sindikatave pjesëmarrëse në protestën e 26 prillit do të jenë të enjten në Bruksel për të zhvilluar takime bilaterale dhe për të marrë informacione të plota dhe këshilla në mënyrë që ky veprim sindikal të jetë i organizuar në nivelin më të lartë të mundshëm dhe t'i arrijë efektet e dëshiruara. Sindikatat pjesëmarrëse në këtë protestë do të kërkojnë një Evropë më të mirë për punëtorët. Do të kërkojnë që për formësimin e të ardhmes së Evropës figurë kyçe të jetë mësuesi.

SBASHK



SINDIKATA E BASHKUAR E ARSIMIT, SHKENCËS DHE KULTURËS

Emergjenca, numër rekord të pacientëve

PRISHTINË, 24 PRILL (ER) - Klinika Emergjente në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës ka shënuar numër rekord të trajtimit të rasteve brenda tre muajve të parë të këtij viti.

Sipas raportit të punës, gjatë kësaj kohe në Emergjencë kanë kërkuar ndihmë mjekësore më shumë se 18 mijë pacientë. Vitin e kaluar, për periudhën janar -

mars, stafi mjekësor në Klinikën Emergjente u ka ofruar shërbimet e nevojshme mjekësore 11 591 personave. Numri i trajtimit të rasteve emergjente në QKUK është rritur pas

investimeve në Klinikën Emergjente nga Ministria e Shëndetësisë për ofrim të shërbimeve më cilësore pacientit dhe kushte më të mira pune stafit mjekësor.



UNDP-ja mbështet Gjykatën Themelore në Mitrovicë me dhjetë përkthyes

PRISHTINË, 24 PRILL (ER) - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) ka nënshkruar të mërkurën një marrëveshje për ta mbështetur Gjykatën Themelore në Mitrovicë me dhjetë përkthyes për të siguruar qasje të barabartë në drejtësi për të gjitha komunitetet. Marrëveshja u nënshkrua nga përfaqësuesja e përhershme e UNDP-së, Alessandra Roccasalvo dhe zëvendëskryetari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Ali Kutllovci. Aktualisht Gjykata Themelore e Mitrovicës ka më

shumë se 10 000 raste gjyqësore urgjente dhe shumica e lënëve duhet të jenë në dispozicion në të dy gjuhët zyrtare, shqip dhe serbisht.

UNDP-ja do ta ndihmojë këtë gjykatë ta zvogëlojë numrin e rasteve të mbetura duke angazhuar dhjetë përkthyes të cilët do të përkthejnë drejtpërdrejt në seancat gjyqësore si dhe do ta bëjnë përkthimin me shkrim të shkresave të lëndëve. Iniciativa do të kontribuojë në zbatimin e ligjit për gjuhët zyrtare dhe për përmirësimin e qasjes

me kohë të drejtësisë për të gjithë.

Përfaqësuesja e Përhershme e UNDP-së, Alessandra Roccasalvo, ka thënë se identiteti i gjuhës është një e drejtë njerëzore siç përcaktohet në nenin 22 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut. "Jemi të lumtur që mbështetja jonë do të kontribuojë në përmirësimin e efikasitetit të gjykatës dhe në përmirësimin e qasjes në drejtësi për të gjithë. Marrëveshja e sotme është pjesë e punës më të gjerë të UNDP-së në fushën e



sundimit të ligjit dhe shpresojmë ta vazhdojmë mbështetjen tonë për institucionet e Kosovës në këtë fushë", ka thënë Roccasalvo.

MSh-ja: Vaksinimi, mënyra më e lirë dhe më efikase për mbrojtjen e fëmijëve nga sëmundjet

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 24 PRILL - Sikur në shumë vende të botës, edhe në Kosovë shënohet Java e Imunizimit 2019. Java Botërore e Imunizimit (24-30 prill) në Kosovë synon që përmes aktiviteteve të organizuara ta rrisë vetëdijësimin për imunizim, rrjedhimisht edhe përmirësimin e statusit shëndetësor të fëmijëve që është prioritet kryesor i Ministrisë së Shëndetësisë, IKShP-së, UNICEF-it e OBSH-së, me qëllim që të parandalohet

rishfaqja e sëmundjeve ngjitëse të cilat shkaktojnë paaftësi dhe vdekje dhe për të siguruar që të gjithë fëmijët të kenë një mundësi të barabartë për një të ardhme të shëndoshë. Vaksinimi i fëmijëve, sipas kalendarit vjetor të vaksinimit të obliguar me ligj, ka krijuar një traditë të mirë në deceniet e fundit në Kosovë. Vaksinimi në shkallë prej mbi 95 përqindësh të fëmijëve në Kosovë, flet për një sukses të përbashkët të MSh-së, IKSHKP-së, UNICEF-it, OBSH-së, si dhe profesionistëve shëndetësorë e prindërve. Gjatë vitit 2019

Ministria e Shëndetësisë ka ndarë 539 000 euro për sigurimin e vaksinave nga kalendari i vaksinimit të obliguar me ligj dhe 350 000 euro për vaksinat sipas indikacioneve epidemiologjike. MSh-ja rikujton se vaksinimi është mënyra më e lirë dhe më efikase për mbrojtjen e fëmijëve nga sëmundjet e parandalueshme përmes vaksinimit. Fëmijët kosovarë meritojnë të kenë vakcina cilësore dhe me kohë. Prandaj, MSh-ja u bënë apel prindërve që t'i vaksinonjë fëmijët e tyre dhe kështu ta mbrojmë shëndetin e tyre.



Në UP nis aktiviteti "Ditët e orientimit për maturantë"

PRISHTINË, 24 PRILL (ER) - Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" të mërkurën ka bërë hapjen zyrtare të aktivitetit "Ditët e orientimit për maturantë". Qëllimi i këtij aktiviteti është njohja e maturantëve për së afërmi me mundësitë e studimit në Universitetin e Prishtinës, ku nga përfaqësuesit e njësive akademike dhe përfaqësues të tjerë të arsimit të lartë për tri ditë me radhë do të prezantohen këto mundësi.

Në ceremoninë hapëse të këtij aktiviteti para të pranishmëve foli prorektorja për zhvillim dhe cilësi në UP, prof. asoc. dr. Merita Kocinaj-Berisha, e cila tha se ky aktivitet është ideuar për t'i informuar maturantët me mundësitë që ofron UP-ja.

"Organizimi i këtij aktiviteti buron nga plani strategjik i UP-së, ku parashihen objektiva strategjike të ndërlikueshme dhe bashkëpunimit me institucione të arsimit të mesëm të lartë, me qëllim informimin dhe orientimin në karrierë për maturantët. Hapjen e parë po e hedhim bashkë sot, duke u siguruar se trasimi i një rruge të gjatë bashkëpunimi dhe mundësish për maturantët do të jetë nevojë e përbashkët institucionale", ka thënë prorektorja Berisha. Ajo ka theksuar se UP-ja është universiteti lider në vend, që ofron për kandidatët mundësi të më të mira për studime. Ndërkaq, në emër të studentëve të UP-së foli studenti Bashkim Hoti nga programi "Studentë

ambasadorë", i cili tha se përzgjedhja e Universitetit të Prishtinës për studime është përzgjedhje e duhur për maturantët. Për informimin e maturantëve, në këtë aktivitet po marrin pjesë përfaqësues nga 13 njësitë akademike, si dhe përfaqësuesit e zyrave dhe qendrave brenda UP-së të cilët do t'i informojnë maturantët rreth studimeve në UP.

Hapjen e këtij organizimi i ka paraprirë një takim mirëprirës me drejtorët e drejtorive komunale të arsimit, i mbajtur në Rektoratin e Universitetit të Prishtinës, ku është diskutuar për krijimin e urave të bashkëpunimit ndërmjet UP-së dhe institucioneve të arsimit parauniversitar. Ky aktivitet orientues për



nxënës është organizuar nga Qendra për Zhvillim të Karrierës dhe zyra e rektorit të UP-së, si dhe është mbështetur nga Busulla - portali zyrtar i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

për orientim profesional, edukim dhe këshillim në karrierë. Aktiviteti do të jetë i hapur për maturantë deri më 26 prill në hapësirën e Bibliotekës Kombëtare "Pjetër Bogdani".

Shkrirja e KPMM-së në ShGJK cilësohet antiligjore

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 24 PRILL - Shkrirja e Komisionit të Pavarur për Mineral dhe Minerale (KPMM) në Shërbimin Gjeologjik të Kosovës (ShGJK) do të shënojë regres për sektorin mineral në Kosovë, do ta dekurajojë thithjen e investimeve të huaja, do të ndikojë në rënien e normës së punësimit dhe zhvillimit ekonomik, si dhe do të paraqesë amulli për këtë sektor. Këto konkluzione dolën të mërkurën në tryezën e organizuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, ku është kundërshtuar projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënese të agjencive të pavarura, i cili parasheh që KPMM-ja të shkrihet në Shërbimin Gjeologjik të Kosovës. "Nëse KPMM-ja shkrihet apo bashkohet me ShGJK-në do të vijë deri te defunksionalizimi dhe do të shënojë regres sektori mineral, po ashtu paraqet edhe konflikt interesi, si dhe ristrukturimi bie ndesh me strategjinë minerare. Kjo do ta godasë ekonominë pasi në këtë sektor, sipas ASK-së, llogaritet të jenë të punësuar 20 000 persona dhe kemi, po ashtu, të hyra 20 milionë euro nga renta minerare", ka thënë Kemajl Zeqiri, anëtar i

bordit të KPMM-së. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënese të agjencive të pavarura është propozuar nga Ministria e Administratës Publike. Drejtori i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, Ramiz Krasniqi, ka deklaruar se ky projektligj është në debat publik dhe parasheh që ky komision të jetë pjesë e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, "në të cilin draft është paraparë që Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale të jetë pjesë e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, përkatësisht të bëhet bashkëdyzimi i dy agjencive apo Shërbimit Gjeologjik për Miniera dhe Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale", u shpreh Krasniqi. Edhe kryetari i bordit të KPMM-së, Musa Shabani, ka kundërshtuar që KPMM-ja të shkrihet në Shërbimin Gjeologjik të Kosovës. Ai ka thënë se një gjë e tillë është shkelje e standardeve evropiane. Sipas Shabanit, hartuesit e këtij projektligji nuk kanë njohuri në sektorin mineral, andaj ka kërkuar një rishikim. Shabani ka folur edhe për Ligjin për Miniera dhe Minerale, i cili ndodhet në lexim të dytë, për të cilin beson se do ta rregullojë edhe më shumë çështjen e funksionimit



dhe pavarësisë së këtij komisioni. Sipas tij, Shërbimi Gjeologjik i Kosovës nuk mund të japë licenca për hulumtim pasi kjo është përgjegjësi e KPMM-së. "E kundërshtojmë në tërësi këtë projektligj, pasi bie në kundërshtim me ligjin bazë për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura. Gjithashtu, bie në kundërshtim me strategjinë minerare të Kosovës 2011-2025, në kundërshtim me pavarësinë e marrjes së vendimeve larg ndikimeve

politike, frikëson investitorët seriozë dhe potencialë që pretendojnë të investojnë në Kosovë, defunksionalizon funksionimin e dy institucioneve si KPMM-në dhe Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, ullet në nivel të departamentit vendim-marrja, shkëputet lidhja me Kuvendin dhe llogaridhënia. Pra, shihet qartë që hartuesit e projektligjit nuk e kanë njohur mirë funksionimin e sektorit të minierave dhe mineraleve në Kosovë", është shprehur Shabani.

Nga Departamenti për Miniera në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Skender Sallahu ka thënë se ashtu siç e parasheh ligji për projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënese të agjencive të pavarura që licencimi, hulumtimi dhe kontrolli nuk mund të bëhet në një vend. Sipas tij, edhe aspekti i licencimit që tani e bën KPMM, nëse i kalon Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, mund të paraqesë konflikt interesi.

Ministri Shala dhe kryetari i Ulqinit meren vesh për rritje të bashkëpunimit në fushën e turizmit



PRISHTINË, 24 PRILL (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka pritur të mërkurën në takim kryetarin e Komunës së Ulqinit, Loro Nrekiç, me të cilin kanë diskutuar për thellimin e bashkëpunimit në fushën e turizmit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi. Ministri Shala ka theksuar se Qeveria e Kosovës është duke punuar që turizmin ta zhvillojë edhe më shumë, që edhe qytetarët e rajonit të vijnë dhe ta vizitojnë Kosovën. "Me krijimin

e Departamentit të Turizmit ne po krijojmë politika të reja të zhvillimit të turizmit në Kosovë, kryesisht në vendet që janë të njohura. Po inkurajojmë zhvillimin e infrastrukturës që t'u krijojmë kushte sa më të mira turistëve që vijnë nga vendet e rajonit për të parë bukuritë e vendit tonë. Besoj dhe shpresoj se bashkëpunimi në mes të Kosovës dhe Ulqinit nuk do të jetë më vetëm në një rrugë njëkahëshe, por të bëhet një bashkëpunim reciprok dhe ta

krijojmë një turizëm të kombinuar", ka thënë ministri Shala. Ai ka shtuar se gjatë verës shqiptarët ta vizitojnë bregdetin e Ulqinit por, gjithashtu, edhe gjatë vjeshtës dhe dimrit, si Rugova, Brezovica dhe Prevala të vizitohen nga qytetarët e Ulqinit në mënyrë që turizmi të ketë një rritje graduale. Po ashtu, ministri me kryetarin e Ulqinit u morëm vesh për eliminimin e ngarkesave në mes të dy vendeve, që të rritet potenciali turistik Kosovë - Mali i Zi.

Ujësllësi dërgon borxhlinjtë te përmbaruesit privatë

PRISHTINË, 24 PRILL (ER) - Kompania Rajonale e Ujësllësit 'Prishtina' nëpërmjet një komunikate për medie ka bërë me dije se ka formuar komisione të veçanta për verifikimin dhe dërgimin e lëndëve të konsumatorëve borxhlinj te

përmbaruesit privatë. "Përveç aplikimit masiv të shqycjeve individuale nga sot lëndë të shumta të konsumatorëve borxhlinj do të procedohen te përmbaruesit", është theksuar në komunikatën e dërguar nga KRU 'Prishtina'.

Përveç konsumatorëve që kanë obligime të pashlyera ndaj shërbimeve të ujësllësit dhe kanalizimit, te përmbaruesit do të shkojnë edhe konsumatorët të cilët kanë përfitur nga Ligji për Faljen e Borxheve Publike dhe të cilët

nuk u janë përmbytur kontratave të nënshkruar nga të dyja palët. "Borxhi total ndaj shërbimeve të ujësllësit dhe kanalizimit është mbi 40 milionë euro. Nga Ligji për Faljen e Borxheve Publike kanë përfitur mbi 52 mijë



konsumatorë, ku një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk u janë përmbytur marrëveshjes kontraktuale", është thënë më tutje në këtë komunikatë.

Hapet Panairi Ndërkombëtar 'Prishtina 2019', bëhet thirrje për konsum të prodhimeve vendore

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 PRILL - Të mërkurën në kryeqytet është hapur Panairi i Ndërkombëtar "Prishtina 2019", organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës. Në këtë panair po marrin pjesë 100 ndërmarrje nga Kosova, rajoni dhe më gjerë.

Drejtori i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka thënë se ky vit do të jetë vit i ekonomisë. Ai gjatë fjalës së tij ka thënë se ka rritje të numrit të kompanive pjesëmarrëse në panair dhe bëri thirrje që fokusi për siguri dhe shëndet në punë të jetë më i madh. "Sot kemi 100 kompani

nga shtetet më të rëndësishme nga rajoni dhe Evropa. Besojmë se panairi është një nga mundësitë kryesore që ta prezantojmë ekonominë tonë dhe korrespondon edhe me atë që e ka proklamuar qeveria, që ky vit do të jetë vit i ekonomisë. Bizneset duhet të fokusohen më shumë te siguria dhe shëndeti i punëtorëve në punë, prandaj mos të na përsëriten rastet sikurse që po shohim në ditët e fundit", ka thënë Rukiqi.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, para të pranishmëve ka listuar veprimet që Qeveria e Kosovës pritet t'i ndërmarrë sa iu përket ligjeve që përmirësojnë mjedisin e të bërit biznes. Ai ka thënë se viti 2019 është vit i

ekonomisë dhe, sipas tij, pas stabilizimit të pagave në sektorin publik, sektori privat do ta ketë përkushtimin e plotë të ekzekutivit.

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka shprehur mirënjohje për prodhuesit e Kosovës që me punën e tyre po kontribuojnë për zhvillimin ekonomik të vendit, hapjen e vendeve të reja të punës dhe përmirësimin e bilancit tregtar. Ministri Shala ka theksuar se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë fokus kryesor e ka mbështetjen e prodhuesve vendorë, që sot i ekspozuan produktet e tyre shumë cilësore në Panairin e Përgjithshëm Ndërkombëtar "Prishtina 2019".

"Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë janë të përkushtuara për përkrahjen e prodhuesve vendorë që t'i certifikojnë produktet e tyre, që të jenë të gatshëm dhe konkurrentë për tregjet e huaja. Të vazhdoni të punoni që ta rrisim cilësinë e prodhimeve tona, që ta rrisim edhe tregun dhe besimin në produktet 'Made in Kosova', ka thënë Shala.

Ministri ka theksuar se të gjitha aktivitetet dhe projektet në kuadër të MTI-së kanë për qëllim mbështetjen e kompanive kosovare. "Shfrytëzoj rastin t'i ftoj të gjitha kompanitë kosovare dhe përfaqësuesit e tyre, si Odën Ekonomike, ta vazhdojmë dhe ta avancojmë bashkëpunimin tonë

drejt këtyre objektivave. Këto janë sfida, por edhe mundësi të mëdha dhe mund t'i realizojmë vetëm duke bashkëpunuar. Nga këtu edhe një herë ju shprehim mirënjohje të veçantë prodhuesve kosovarë, të cilët me punë po kontribuojnë në zhvillimin e ekonomisë së vendit", ka thënë ai.

Ministri ka shtuar se MTI-ja çdoherë do të jetë përkrah bizneseve dhe do të ndihmojë për zgjidhje të problemeve të tyre, duke bërë thirrje që të konsumohen prodhimet vendore. Nga një fjalë rasti e kanë mbajtur edhe ministri i Inovacionit, Besim Beqaj dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka.



PSD-ja nis petitionin për rritjen e pagës minimale në Kosovë

PRISHTINË, 24 PRILL (ER) - Partia Socialdemokrate (PSD) ka iniciuar një petition online për mbledhjen e nënshkrimeve për rritjen e pagës minimale në Kosovë. Kjo parti ka kërkuar ndihmën e qytetarëve për

realizimin e kërkesës së saj për rritjen e pagës minimale. Sipas PSD-së, mbështetja e qytetarëve rritë presionin ndaj qeverisë për ta marrë këtë vendim. "Jemi shumë afër realizimit të kërkesës sonë për rritjen e

pagës minimale në sektorin privat në Kosovë, por tash na duhet ndihma e secilit prej jush që t'i bëjmë presion qeverisë për ta marrë këtë vendim. Ju ftojmë ta nënshkruani këtë petition online (www.petitione.com). Dy

minuta nga koha juaj, mund të ndikojnë në rritjen e kualitetit të jetës për shumë qytetarë që punojnë në sektorin privat në Kosovë", është thënë në njoftimin e PSD-së në llogarinë e saj në "Facebook".

PSD
PARTIA
SOCIALDEMOKRATE



Ka filluar të mbahet testi ndërkombëtar TIMSS

PRIZREN, 24 PRILL (ER) - Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) ka filluar mbajtjen e testit ndërkombëtar TIMSS për vlerësimin e nxënësve për klasat e katërta për prijet në matematikë dhe shkenca natyrore. Në këtë vlerësim, i cili ka filluar të mërkurën në regionin e Prizrenit dhe Gjakovës dhe do të zgjasë deri

më 10 maj 2019 në regionet e tjera, do të marrin pjesë rreth 5 000 nxënës nga 148 shkolla të Kosovës. Testi TIMSS organizohet nga Organizata Ndërkombëtare për Vlerësimin e të Arriturave në Arsim (IEA), ndërsa në këtë vlerësim marrin pjesë 60 shtete, ndër të cilat edhe Kosova. Komisioni shtetëror për testet

ndërkombëtare, i emëruar nga ministri Shyqiri Bytyqi, ka mbajtur të mërkurën një takim, ku është theksuar se falë bashkëpunimit të mirë me komunat, gjithçka ka shkuar sipas planifikimit dhe testi ka filluar të realizohet me sukses. TIMSS mbahet çdo katër vjet, ndërsa në Kosovë po realizohet për herë të parë.



Në Prizren arrestohen dy persona për 'vjedhje të rëndë'

PRIZREN, 24 PRILL (ER) - Në Prizren hetuesit policorë, pas një pune hetimore intensive të njësiteve relevante, kanë arritur t'i identifikojnë dhe t'i arrestojnë dy persona të dyshuar (A. M. dhe A. K.), të cilët dyshohet të kenë kryer veprën penale 'vjedhje e rëndë'. Personat e dyshuar, tashmë të arrestuar, dyshohet

të jenë përfshirë në një rast të ndodhur më 14 prill 2019 në rrugën "Jusuf Gërvalla" në Prizren. "Të dyshuarit, duke vepruar në mënyrë të vrazhdë, ia kanë marrë nga dora viktimës kuletën, në të cilën ka pasur dokumente personale dhe të holla në vlerë rreth 80 euro. Në vazhdim të dyshuarit dyshohet se kanë kryer edhe dy

vjedhje, raste të ngjashme me këto, të cilat vepra i kanë pranuar në praninë e prindit dhe avokatit mbrojtës. Të njëjtit konsiderohen si recidivistë të këtyre veprave penale. Me vendim të prokurorit të dyshuarve u shqiptohet masa e ndalimit policor për 24 orë", është bërë me dije në njoftimin e Policisë së Kosovës.

Përmbillet faza e fundit e zbatimit të vendimit për mbulimin e shpenzimit të varrimit në Skenderaj

Skenderaj, 24 prill (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka bërë me dije se kanë arritur si komunë të përmbyllin edhe fazën e fundit, për ta nisur zbatimin e vendimit për mbulimin e shpenzimit të varrimit në aspektin teknik, si dhe shërbimeve përcjellëse fetare për

qytetarët e Komunës së Skenderajt. "Me kryetarin e Këshillit të Bashkësisë Islame në Skenderaj, Nexhmi ef. Maksuti kemi nënshkruar memorandumun e mirëkuptimit që, përveç të tjerash, liron të gjithë qytetarët nga shpenzimet e domosdoshme për rastet mortore. Edhe një

sqarim rreth vendimit të qeverisjes sime, meqë ka pasur debat, nëse ky vendim do ta mbulojë edhe pagesën e anëtarësisë ndaj Këshillit të Bashkësisë Islame. Vendimi që kemi marrë nuk i liron qytetarët nga përgjegjësia e tyre për pagesën e anëtarësisë", ka thënë Bekim Jashari.



Komuna e Shtimes organizon trajnim për fermerët shtimjanë

SHTIME, 24 PRILL (ER) - Komuna e Shtimes dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR), në bashkëpunim me Qendrën Informative të Bujqësisë në këtë komunë, do ta organizojnë trajnimin me fermerë me temën "Sëmundjet parazitare të kafshët". Ligjërues në këtë trajnim do të

jetë Xhavit Bytyqi. Trajnimi do të mbahet më 26 prill (e premte) nga ora 11:00, në sallën e vjetër të Kuvendit të Komunës së Shtimes (kati përdhes). Ky trajnim është duke u mbështetur nga projekti "Zhvillimi i zonave rurale përmes avancimit të shërbimeve këshillimore", ndërkaq është duke u implementuar nga ESG-ja.

Gjendet personi i zhdukur në Pejë

Pejë, 24 prill (ER) - Policia e Kosovës, konkretisht Stacioni Policor në Pejë, më 22. 4. 2019 ka pranuar informatë nga ankuesi, vëllai i viktimës, se më 20. 4. 2019, rreth orës 11:30, viktimë është larguar nga shtëpia dhe nuk dihet vendndodhja e tij. Hetuesit e Stacionit Policor në

Pejë kanë punuar intensivisht, pasi që është marrë përshkrimi i viktimës nga familjarët, për ta gjetur personin e paraqitur të zhdukur. "Pas një bashkëpunimi me të gjitha rajonet e Policisë së Kosovës është arritur të identifikohet dhe të gjendet personi i zhdukur. I njëjti është intervistuar

nga hetuesit e Stacionit Policor në Pejë dhe nuk ka dhënë ndonjë indikacion se ka pasur presion apo shtytje nga dikush për largimin e tij nga shtëpia. I njëjti, pas intervistimit, është kthyer në shtëpi", është thënë në njoftimin për media të Policisë së Pejës.



Politika ndaj pakicave përshpejton integrimin e shtetit në BE

Shkruan: Mr. Kristjan
DUKAJ

Procesi i bisedimeve për integrimin e vendit në BE, sipas vlerësimeve të institucioneve relevante, është duke u zhvilluar sipas dinamikës së paraparë e që paralajmëron rrugëtimin e suksesshëm në këtë proces. Por, pavarësisht prej mendimit pozitiv lidhur me rrjedhën e procesit integruar, ende mbetet shumë punë për t'u bërë në mënyrë që Mali i Zi sa më parë të jetë pjesë e bashkësisë së vendeve evropiane. Angazhimi i deritashëm i shoqërisë malazeze dhe institucioneve të tij e kanë sjell Malin e Zi në pozitën e liderit në rajon në procesin e integrimi. Andaj, është obligim parësor i institucioneve përkatëse, të shfrytëzojnë përparësitë e pozicionimit të këtyre dhe në afatin më të shkurtër të bëhet anëtar i radhës i BE. Jo për shkak të dëshirës por si nevojë që sa më parë të përvetësojmë vlerat Evropiane të jetës; për punë, shkollim, shoqërinë e barazisë sociale me shanse dhe mundësi të barabarta.

Në këtë kontekst, strategjia e politikës së pakicave, respektivisht, realizimi i të drejtave të pakicave, paraqet një rëndësi nga urat kryesore në procesin e përgjithshëm të Integrimi Evropiane. Jo rrallë, kjo problematik shqyrtohet në nivelet më të larta, nacionale dhe ndërkombëtare. Me mbajtjen e tubimeve të tilla në këtë temë, dëshirohet, apriori, të sigurohet hapësirë më adekuate për realizimin e politikës së proklamuar siç qëndron edhe në aktin më të lartë juridik të vendit dhe aktet tjera ndërkombëtare, konventat dhe marrëveshjet bilaterale.

Është fakt se popujt pakicë i kanë dhënë përkrahje të pazezervë procesit të integrimi të bindur se sukcesi i këtij procesi kontribuon pozitë më kualitative të tyre në të gjitha nivelet. Të vetëdijshëm se pozita e pakicave në një vend në mas të madhe

mund të jetë pengesë në procesin e negociatave, Mali i Zi ka harmonizuar legjislaturën nacionale me përvojat e ngjashme të vendeve të BE. Me Kushtetutën e Malit të Zi, si dhe me aktet dhe dispozitat tjera ligjore, është definuar korniza institucionale e politikës ndaj të drejtave të pakicave. Kushtetuta, si akti më i lartë juridik i vendit, paraqet bazën themelore në promovimin, përforsimin dhe avancimin në mbrojtjen e të drejtave lirive themelore të njeriut, pjesë e pandashme e të cilave janë edhe të drejtat e popujve pakicë.

Me Kushtetutën e Malit të Zi, neni 6, garanton mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, si kategori të patjetërsueshme. Kurse, neni 7, ndalon diskriminimin mbi çfarëdo baze qoftë. Krahas legjislaturës nacionale e cila garanton respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, Mali i Zi, me dispozitat e nenit 9, të Kushtetutës, ka përcaktuar se "kontratat e miratuara ndërkombëtare dhe rregullat e aprovuara të përgjithshme nga fusha e të drejtës ndërkombëtare janë pjesë përbërëse të rendit të brendshëm juridik dhe, si të tilla, kanë përparësi ndaj legjislaturës vendase

dhe se zbatohen drejtpërdrejt në rastet kur raportet i rregullojnë ndryshe nga legjislatura e brendshme". Në kuadër të drejtave të veçanta të pakicave, konsiderohen edhe të drejtat shtesë të cilat popujve pakicë në Mal të Zi, ua garanton Kushtetuta dhe dispozitat e parapara ligjore, qëllimi i të cilave është mbrojtja e identitetit të përgjithshëm nacional. Konform kësaj, në pjesën e dytë të Kushtetutës, me nenin 79, pjesëtarëve të popujve pakicë dhe të bashkësive tjera nacionale, u garantohej të drejtat dhe liritë të cilat mund të shfrytëzojnë individualisht ose në bashkësi me të tjerët, ku mes tjerash, duhet veçuar:

- e drejta në përfaqësimin autentik në Parlamentin e Malit të Zi dhe parlamentet e njësisë të vetëqeverisjes lokale në të cilat përbëjnë përqindje të konsiderueshme të popullsisë, në pajtimin me principet e aksionit afirmativ;
- përfaqësimi proporcional në shërbimet publike, organet e pushtetit qendror dhe vetëqeverisjen lokale.

Kuptohet se realizimi i normave të parapara duhet të jetë sfidë, në veçanti, për ata që janë drejtpërdrejt përgjegjës në zbatimin e tyre në punë dhe veprimtari të

përditshme e që, individin apo bashkësinë e bëjnë të sigurt, nëse jo edhe të kënaqur dhe kjo duhet të jetë qëllimi i pushtetit ekzekutiv të Malit të Zi në realizimin e strategjisë së politikës ndaj pakicave.

Duke folur me gjuhën e shifrave në mungesën e studimit dhe analizës së detajuar, nuk kemi të dhëna precize statistikore e që do të pasqyrojnë qartë gjendjen në fusha të ndryshme kur është fjala për realizimin e strategjisë së politikës ndaj pakicave, sepse në bazë të dhënave parciais nuk mund të vërtetohen faktet për nivelin e arritur në këtë fushë. Andaj, aktivitetet në përpunimin e të dhënave në pasqyrimin e situatës ekzistuese duhet koordinuar mes ministrisë përkatëse dhe institucioneve tjera të kyçura në këto projekte. Kur është fjala për pakicën nacionale të shqiptarëve në Mal të Zi, sipas të dhënave në dispozicion, përfaqësimi i tyre në organet e legjislaturës publike nuk është në proporcion me përqindjen prej 4.9 për qind sa është pjesëmarrja e tyre në numrin e popullsisë së përgjithshme në Mal të Zi.

Edhe pse rezultatet e deritashme janë përpunuar kryesisht në mënyrë parciais dhe variojnë nga 1.5 për qind deri në 2.8 për

qind, varësisht nga periudha dhe institucioni që kanë punuar në grumbullimin e të dhënave, është e qartë se ajo ende nuk është në nivelin e duhur. Natyrisht se nuk është fjala për respektimin strikt të normave në përqindje por, duke marr parasysh faktin se një numër i madh i të rinjve nga këto hapësira, vite me radhë është duke u shkolluar në qendra prestigjioze universitare në Mal të Zi dhe jashtë tij, duhet dhënë shansin kuadrove të rinj të arsimuar, që me angazhimin e vet profesional të kontribuojnë në përvetësimin e standardeve demokratike, respektivisht ndërtimin e Malit të Zi si shtet të barazisë sociale.

Tentativat e deritashme që të kihen një pasqyrim më i qartë i situatës ekzistuese nuk kanë dhënë rezultatet e dëshiruara. Andaj, siç është paralajmëruar nga Këshilli Kombëtar i Shqiptarëve, (KKSH), puna në studimin e gjendjes aktuale në këtë fushë do të kontribuojë në procesin e avancimit të drejtave të pakicave. Avancimi i gjendjes në këtë fushë, përveç integritit të bashkësisë, s'ka dyshim, edhe nëse nuk do të ndalojë me siguri do të ngadalësojë largimin e kuadrove të rinj në botën e jashtme. Njëkohësisht, Mali i Zi si demokraci në zhvillim, me integrimin maksimal të pakicave në sistemin e vlerave, do ta dëshmojë pozicionin e vendit lider në miratimin e parimeve të pranuar në rrafshin më të gjerë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, i cili ende nuk mund të lavdërohet me nivelin e arritur në zgjidhjen e çështjeve të shumta nga kjo fushë. Sa më shumë që të jenë popujt pakicë dhe bashkësitë tjera të pakicave aktive dhe të integruara në bashkësinë e gjerë shoqërore, aq më parë do të krijohen kushtet për përparimin më të shpejtë dhe më të suksesshëm të gjithë shoqërisë në procesin e integrimi drejtë BE-së.

(Autori është politolog,
magjistër i diplomacisë dhe
marrëdhënieve ndërkombëtare)



Gashi e Berisha: Ndryshimi i kufijve sjell përkeqësim të situatës në Ballkan


TIRANË, 24 PRILL (ER) - Kryetari i Partisë Liberale të Kosovës (PLK), Skender Gashi, është takuar me ish-kryeministrin e Shqipërisë, Sali Berisha, me të cilin ka biseduar për zhvillimet politike në të dy shtetet shqiptare. "Sot kam takuar ish-kryeministrin e Shqipërisë, lideri i parë shqiptar që bëri ndryshimet nga sistemi komunist në sistem demokratik në vitin 1991, dr. Sali Berisha. Takimi u zhvillua në nivel zyrtar dhe miqësor, rreth çështjes politike,

ekonomike dhe sociale në Republikën e Shqipërisë dhe Kosovës. Po ashtu, biseduam edhe rreth gjendjes politike në trojet shqiptare", ka shkruar Gashi në llogarinë e vet në "Facebook".




Ai ka thënë se me Berishën ka biseduar edhe për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. Gashi ka thënë se me Berishën janë pajtuar që ky proces të përfundojë pa prekjën e kufijve ekzistues të Kosovës. "Biseduam

edhe për proceset politike që po zhvillohen ndërmjet Kosovës e Serbisë, që ky proces të mbyllet sa më parë dhe kufijtë të mbesin ashtu siç janë pranuar nga shtetet ndërkombëtare dhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Ndryshimi i kufijve sjell përkeqësim të situatës në Ballkan. Për mua ishte nder dhe kënaqësi e madhe ta takoj dhe të bisedoj me dr. Sali Berishën, i cili bisedat i bëri në mënyrë konstruktive dhe reale", ka shkruar Gashi.





TOP PAKO

-  Komunikim **FALAS**
-  Internet deri në **50Mbps**
-  Televizion Digjital

Për vetëm 17euro

TOP PAKO, PËR TË GJITHË!

TOP Pakot përmbajnë të gjitha shërbimet e nevojshme të komunikimit për biznese të vogla por edhe për familje.

Prej vetëm 17.00€, **10 numra me komunikim FALAS**, PLUS:

- ∞ minuta drejt IPKO-së;
- ∞ SMS;
- Internet në mobil deri në 5GB;
- Televizion digjital dhe Internet deri në **50Mbps**;
- Telefoni Fikse me tarifa standarde;

Për më shumë informata, vizitoni dyqanin më të afërt të IPKO-së.

WWW.IPKO.COM





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

- Quality & Sales Award Recipients**
[Listed in alphabetical order]
- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
 - ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
 - ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
 - ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
 - ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
 - ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
 - ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
 - ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
 - ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
 - ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



E jashtëzakonshme

Peshkaqeni rreth 2 tonë mbytet nga breshka gjigante

Një peshkaqeni i bardhë është mbytur duke ngrënë një breshkë deti dhe imazhet janë bërë virale. Pamjet e realizuara nga peshkatari Greg Vella në Japoni tregojnë krijesën rreth 2 tonë të spërkatur me gjak dhe me gojë të hapur. Duket



se peshkaqeni po përpiquej ta kapërdinte breshkën e cila e mbyti dhe i shkaktoi vdekjen.

FOTO E DITES



Një kor i marinës kineze performon gjatë një koncerti me grupet ushtarake kineze dhe të huaja në Qingdao. /AP/

E rrallë

Truprojat pastrojnë trenin para se ta zbresë Kim Jongun

Njerëzit dëshmuar një skenë mjaft të veçantë pas mbërritjes së Kim Jongut në Vladivostok. Kur treni po ndalonte, truprojat e Kimi dolën jashtë në platformë për ta pastruar derën në mënyrë që shefi i tyre të dilte jashtë. Të veshur me kostume dhe doreza të bardha,



burrat nga Koreja e Veriut vrapuan pranë trenit dhe fshinë tërësisht dyert e trenit të blinduar, me të cilin Kimi udhëtoi për takimin e tij të parë me presidentin Vladimir Putin.

BARSOLETA E DITËS



Kryeministri e viziton një çerdhe. I sheh fëmijët duke luajtur dhe i thotë ministrit të Financave:
- Ndajini 5 000 euro për përmirësimin e kushteve të çerdhes.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

“HOW TO TRAIN YOUR DRAGON; The Hidden World” 3D

I Animuar/Aksion Aventure; 1 ore 44 min

Rolet: Jay Baruchel, America Ferrera, Cate Blanchett, Kit Harrington, Craig Ferguson, F. Murray Abraham, etj.
Regjia: Dean DeBlois



Në ora 20:00

“CAPTAIN MARVEL” 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 ore 08 min

Rolet: Brie Larson, Samuel L. Jackson, Ben Mendelsohn, Djimon Hounsou, Lee Pace, Gemma Chan, Annette Bening, Jude Law, etj.
Regjia: Anna Boden, Ryan Fleck



Në ora 18:00 (gjate vikendit ne ora 14:00 dhe 18:00)

“THE KID WHO WOULD BE KING”,

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 ore 50 min

Rolet: Louis Ashbourne Serkis, Dean Chaumoo, Tom Taylor, Rhianna Dorris, Angus Imrie, Rebecca Ferguson, Patrick Stewart, etj.
Regjia: Joe Cornish




Regjia: Joe Cornish

Në ora 22:00
“U S”

Horror/Triller; 1 ore 56 min

Rolet: Lupita Nyong'o, Winston Duke, Elisabeth Moss, Tim Heidecker, Yahya Abdul-Mateen II, Anna Diop, Evan Alex, Shahadi Wright Joseph, Madison Curry, Cali Sheldon, Noelle Sheldon
Regjia: Academy Award®-winning visionary Jordan Peele



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**




DASHI

Ditët e fundit jeni në pritje të një lajmi të rëndësishëm që do të arrijë vetëm sot. Edhe pse do të zhgënjeheni pak, do të rikuperoheni rrugës.



DEMI

Nëse nuk dëshironi të keni kundërshtime nga të gjithë sot, mundohuni të shpjegoheni sa më qartë për gjërat dhe detyrat që ju kërkojnë.



BINJAKËT

Ka disa rrugë ku ju mund të shkëlqeni në karrierën tuaj personale, por ka rrugë të tjera të cilat mund të bëjnë persona afër jush të triumfojnë.



GAFORRJA

Disa argumente të caktuara sot mund të sjellin debate të ndezura në familje. Është mirë që çdo pjesëtar ta dëgjojë tjetrin përpara se të flasë.



LUANI

Keni përballuar shumë sfida kohët e fundit dhe kjo ju ka dhënë mjaft vetëbesim. Mundohuni që në çdo fushë të jeni në të njëjtën frymë.



VIRGJËRESHA

Një situatë emergjente dhe që e kishit neglizhuar sot do t'ju shtrëngojë të rriini shumë më gjatë në punë. Nuk jeni të sigurt nëse do ta zgjidhni.



PESHORJA

Dita do të nisë qetë, por disa të papritura do ta ndryshojnë të gjithë rrjedhën e saj duke ju detyruar t'i anuloni disa plane tuajat.



AKREPI

Keni marrë persipër disa aktivitete të pazakonta për ditën e sotme dhe do të shikoni që mund të jetë pak problem për t'i finalizuar.



SHIGJETARI

Nuk po merrni vendimin më të lehtë nga ana sentimentale, por do t'i bëni shumë mirë një personi të afërt me ju.



BRICJAPI

Nëse sot nuk ju pëlqen të debatoni lidhur me një problem të caktuar, keni gjithë të drejtën të tërhiqeni dhe të tregoheni indiferent.



UJORI

Rreth jush janë krijuar pritshmëri të caktuara sepse keni treguar që mund t'i realizoni dhe të bashkëpunoni në kohë rekord për gjëra të ndryshme.



PESHQIT


Do të vini në zbatim gjithçka që keni mësuar gjatë këtyre ditëve. Sot do të nevojiten patjetër për të zgjidhur një situatë ngërçi.

Britney Spears thyen heshtjen, flet për thashethemet



Britney Spears më në fund e ka thyer heshtjen. Këngëtarja ka folur për thashethemet se ajo po mbahet në një qendër rehabilitimi për shëndetin mendor kundër dëshirës së saj dhe se familja e saj po merr kërcënime me vdekje. Ylli i muzikës pop, që po merr trajtim për shëndetin mendor, e ka pranuar se situata e saj është

"unike", por ka insistuar se gjithçka është në rregull. "Doja thjesht t'ju përshëndesja sepse gjërat që po thuhën për mua kanë dalë jashtë kontrollit. "Ka pasur thashetheme se familja dhe stafi im janë kërcënuar me vdekje, janë thënë kaq shumë gjëra të çmendura", ka shkruar ajo në një postim në "Instagram".



Vanessa Hudgens flet për lidhjen me Zac Efron

Vanessa Hudgens ka folur për marrëdhënien e saj me Zac Efron. Aktorja 30-vjeçare ka zbuluar disa detaje për lidhjen e saj katërvjeçare me aktorin. "Filloi me të vërtetë rastësisht. Unë s'mund të isha më mirënjohëse se kaq që kam pasur këtë marrëdhënie në atë kohë.

Ishte fenomen dhe të gjithë i kishin sytë mbi mua. Ajo lidhje më mbajti të stabilizuar dhe kisha dikë që të mbështetesh", ka thënë ajo. Vanessa dhe Zac përfunduan marrëdhënien e tyre në vitin 2010. Aktorja aktualisht është në lidhje me Austin Butler, me të cilin është që tetë vjet.

Cardi B thotë se i mungon i fejuari



Reperja e famshme Cardi B ka thënë se është duke i munguar i fejuari, Offset. Këtë e ka bërë me dije reperja me anë të një postimi në "Instagram", ku ka thënë që familja është shumë me vlerë. Cardi në fotografinë e publikuar është me vajzën e saj, Culture, duke fjetur në aeroplanin privat të tyre. "Ti na mungon baba. Patëm një vikend të mirë", ka shkruar Cardi. Sipas "Hollywood Life", reperja është larg burrit të saj për shkak të angazhimeve në muzikë.



Amy Schumer nuk ka lindur fëmijën akoma



Aktorja e famshme, Amy Schumer, është akoma shtatzënë. Sipas "People", para disa dite është përfolur që ajo ka lindur fëmijën e saj. Por të kundërtën e

tha e Schumer, ku të martën publikoi një fotografi në rrjetet sociale teksa ishte duke ecur me bashkëshortin e saj. Schumer është në javët e fundit të shtatzënisë, pritet të lind këto ditë.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045 82 82 82

Ekipi i xhudos në krye me Majlinda Kelmendin përfaqësojnë Kosovën në Minsk 2019



PRISHTINË, 24 PRILL (ER) - Ka shkuar në tetë numri i sportistëve që do ta përfaqësojnë Kosovën në Lojërat e Dytë Evropiane Minsk 2019 që mbahen prej 21 deri më 30 qershor në kryeqytetin e Bjellorusisë. Organizatori i LE Minsk 2019 i ka konfirmuar Komitetit Olimpik të Kosovës pjesëmarrjen e pesë xhudistëve tanë Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova, Distria Krasniqi, Akil Gjakova dhe Loriana Kuka, të cilët janë kualifikuar me normë. Distria është bartësja e dytë në kategorinë deri 48 kilogramë,

Majlinda është e katërta (-52 kg), Nora e para (-57 kg), Akili i katërti (-73 kg), ndërsa Loriana e teta (-78 kg). Trajneri i xhudos, Driton Kuka, beson se edhe nga Minsku do të kthehen me medalje. "Normalisht, gjasat janë për medalje dhe besoj se do të kthehem me medalje. Sa e qysh, mbetet të shihet. Në xhudo Lojërat Evropiane janë edhe Kampionat Evropian, domethënë do të jetë shumë garë e fortë", ka deklaruar Kuka për "noc-kosovo.org".

Pikërisht në xhudo, Kosova numëron një medalje të bronzit të fituar nga xhudistja Nora Gjakova, në debutimin e ekipit tonë në Baku 2015. Para xhudistëve, por me ftesë, KOK-ut i është konfirmuar edhe pjesëmarrja e boksieres Donjeta Sadikut, karateistit Alvin Karaqi dhe pingpongistit Fatih Karabaxhaku. Afati i dërgimit të konfirmimeve nuk është mbyllur ende dhe në ditët në vijim ka gjasë të vijë në KOK edhe konfirmimi për ndonjë sportist të sporteve të tjera.

Ministri Gashi premtan rregullimin e stadiumit të KF 'Pashtriku'

ROGOVË, 24 PRILL (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Kujtim Gashi, ka vizituar të mërkurën Klubin e Futbollit 'Pashtriku' në Rogovë të Hasit. Ministri u ka premtuar sportistëve se gjatë këtij viti do të rregullohet stadiumi i fshatit. "Në Rogovë të Hasit, bashkë me nënkryetarin e Komunës së Gjakovës Ramadan Hoti, për vizitë në KF 'Pashtriku', për ta rikonfirmuar përkushtimin tonë, që sportistëve dhe qytetarëve të kësaj treve gjatë këtij viti do t'ia rregullojmë stadiumin e fshatit", ka shkruar Gashi në llogarinë e vet në "Facebook".



SHKURT


Juventus i ofron 36 milionë euro për mbrojtësin grek Manolas

Juventus është në kërkim të një qendërmbrojtësi me përvojë për ta vënë në krah të Bonuccit dhe emri që ka përfunduar në krye të listës është ai i grekut të Romës, Kostas Manolas. Ky i fundit luan prej pesë sezonesh te Roma, ndërsa po tregon një nivel mjaft të lartë dhe ka tërhequr vëmendjen e shumë klubeve në Evropë. Bardhezinjtë janë gati të ofrojnë 36 milionë euro për kartonin e tij, aq sa janë parashikuar në klauzolën e prishjes së kontratës me Romën.



Ronaldo dorëzon listën me gjashtë lojtarët e Realit që i do te Juventus

Cristiano Ronaldo u ka thënë shefave të Juventusit të bëjnë oferta te ish-klub i tij Real Madrid këtë verë për ta përforcuar skuadrën Bianconere.



"Corriere dello Sport" shkruan se Ronaldo i ka dorëzuar Juventusit një listë prej gjashtë lojtarësh të cilët i dëshiron në ekipin e Juventusit. Në krye të listës janë ish-shokët e vërtetë të Ronaldos, Raphael Varane dhe Isco, së bashku me Joao Felix. Në pikëpamjet e Ronaldos janë edhe mesfushori i Lyon Tanguy Ndombele, anësori i Fiorentinës Federico Chiesa dhe mbrojtësi i Kostas, Manolas. Superylli 34-vjeçar do të ishte i dëshpëruar nëse nuk do ta fitonte titullin e Ligës së Kampioneve para se të largohet nga Juve.

Ngecin negociatat për rinovim, Unitedi kërkon zëvendësimin e De Geas

Jan Oblak është zgjedhja e parë për portën e Manchester Unitedit pasi që, sipas Metros, Unitedi ka bërë përgatitjet e duhura nëse De Geas refuzon rinovimin. Besohet se spanjulli dëshiron t'i afrohet pagës prej 400 mijë funtash në javë që e ka Alexis Sanchez. Por, Unitedi nuk dëshiron që të paguajë shuma të tilla dhe ka tashmë zëvendësimin pasi negociatat për kontratë kanë ngecur. Me 116 porta të paprekura në 202 ndeshje, Oblak gëzon respektin si një prej portierëve me statistikat më të mira në botë. Ndërkaq David De Gea konsiderohet si alternativë për transferim të Real Madridit.





Autor: GAZMEND MORINA		PENGESË A VËSHTIRËSI E PAPRITUR, QË NA DEL PËRPARA	FORMIMI I PËRGJITHSHËM E I VEÇANTË I NJERIUT	POLITIKANI SHQIPTAR EDI	IRISH FOOTBALL ASSOCIATION	DEGË E GJUHËSISË, QË STUDIOJ MJETET TINGULLORE TË NJË GJUHE	KËNGËTARJA ... KOÇI	RENS ISTVUD	ZANORE	EPOKA E RE	EMËR I VJETËR PËR VIETNAMIN	DAMAR I GJAKUT	
PJESË ANËSORE RRETH E RROTULL DIÇKAJE										ADRIAN KRASNIQI FUSA KU ZHVILLOHET NJË PËRLESHJE			
TËRËSIA E GJALLESAVE NË TOKË									NJËRA NGA SIPËRFAQET KUFIZUESE TË NJË SENDI KRIJIM I ANIMACIONI				
SHTET NË EVROPË (pashq.)								ZEZAK ISH MAFIOZI .. KAPONE					
U ARRATISA					ZANORE DY BASHKË-TINGËLLORE		PAGJAKËSI ZBRITJE E AVIONIT NË TOKË						
MINUS (Mat.)					DIKTATOR RUS RAFT						BASHKËT. TRUP QIELLOR QË RROTULLOHET RRETH NJË PLANETI (sh.shq.)		
E ÇMPREH								VËLLIMI, SASIA KUSARI					
TITULL I DIKURSHËM I PERANDORIT OSE I MBRETTIT NË DISA VENDE SLLAVE						THEPI, CEPI LEGJENDA E "KUNG FU-së" LEE (shqip.)				ANA RUSO SHKRIMTARI ZOLA			
EPOKA E RE	SHKRIMTARI SHQIPTAR NË FOTO	E ZURA ME DORË	SHKURTABIQ	SHKOVA NË KËMBË, LËVIZA (bised.)	SECILA NGA TRAJTAT E NDRYSHME QË MERR EMRI	ZANORE AI QË E KISHTE DOBËSI THEMBRËN	PËRFUNDIMET DIKTATORI ITALIANI MUSOLINI					BARI I KORRUR E I THARË	
NJË PLANET NË SISTEMIN DIELLOR	○						ILAÇ			ISMET RAMUSHI			
QË LARGOHET SHPEJT NGA NDONJË RREZIK	○						EMPLOYEES NUNAVUT UNION KRYEQYTETI I KANADASË			KRYEQYTETI I FILIPINEVE TRAJNERI GJERMAN ... REHAGEL			
SHËRIM, PËRMIRËSIM SHËNDETI	○					"SOMALIA" MËNYRË E SHQIPTIMIT ME HUNDË TË TINGUJVE (ling.)				KRYEQYTETI I ESTONISË (pashq.) NËNË (krah.)			
OSE	○			FUTBOLLISTI LALA KRYEQYTETI I JORDANISË (pashq.)			KRYEMINISTRI I TURQISË REXHEP ERDOGAN THIKA QË MBAHEJ SI ARMË BREZI				TEDI ALVES GRUP I VOGËL BESIMTARËSH ME NJË DO-GMË TË VEÇANTË (shq.)		
KËNGËTARJA VALENTINA	○				I SULMON ELEKTRODA E POLIT POZITIV NË NJË BURIM RRYME					OKSIGJEN, SELEN KËSTI BANKAR		FUTBOLLISTI BUSHI	
BASHKËT.	○	KËNGËTARJA ANGLEZE BUNTON KRYENGRITJA			ENË DRURI PËR TË MBAJTUR BULMET BIMË ME TRUNG TË TRASHË					MODERAT-ORJA HOTI PEMË E VENDEVE TË NGROHTA			
SHTET NË EVROPË	○					KAFSHË MËMË (shq.) KËNGËTARJA E FAMSHME MEKSİKANE RUBIO				KLUB FUTBOLLI NË SUEDI KËNGËTARJA SKOCEZE ... LENOKS		SHKRONJA XVI NITROGJEN	
"TETOVA"	○		SHPEND UJI SHTEGTAR PËR PARIA E SHOQËRISË (sh.shq.)			TRUP QIELLOR QË RROTULLOHET RRETH DIELLIT I VRAZHDE					TANTAL, BOR LLOJ PIJE ALKOOLIKE (shq.)		
HEROINË SHQIPTARE ... PALIKUQI	○			NJËRA NGA "EMIRATET E BASHKUARA ARABE" LLOJ GJELLE						METODË STUDIMI ELIZABETH TAYLOR			
EPOKA E RE	KËNGËTARJA ... LILA HOV, VRULL					ELEMENT KIMIK (shq.) BASHKËT.				ZANORE ISH FUTBOLLISTI ANGLEZ SHEARER (org.)	OLIVER NEUVILLE UNIVERSITETI I PRISHTINËS		
KËNGËTARJA ... ZAHARIA					PORTOFOLI SHKRONJA TË NJËJTA							KANDËRR E VOGËL DHE E ZEZË QË BREN DRURIN	
NJËSI PËR MATJEN E LËNGJEVE BANJË ALLATURKA (shq.)						HISTORIANI ROMAK LUKRECI				LLOJ PIJE E VENDEVE ORIENTALE DRITËRO AGOLLI		BASHKËT. ROMA, NAPOLI	
➤						ALEN NURI BASHKËT.					ROBERT REDFORD ZANORE		
VEPËR E JOSIP RELËS					DHOMA KU MBAHET MËSIMI NË SHKOLLË							JONI ME NGARKESË NEGATIVE	



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të bazë të nenit 12, paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L- 149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin Nr.04/L-077, për Marëdhënjet e Detyrimeve, Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve bënë:

Shpallje të konkursit publik Për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

1. Emri i Institucionit:	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
2. Titulli i Vendit të Punës:	Asistent Ekzekutiv i Kryetarit të KQZ-së
3. Numri i referencës:	KQZ-10/2019
5. Grada e Vendit të Punës:	NA – G8 / K – 12
6. Lloji i kontratës :	Gjashtë (6) muaj
9. Raporton tek:	Kryetari i KQZ-së
10. Vendndodhja:	Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Aranzhon takimet e Kryetarit-ës të KQZ-së;
2. Procedon çështjet administrative lidhur me funksionimin efikas të Zyrës së Kryetarit të KQZ-së.
3. Në emër të kryetarit-ës së KQZ-së, pranon, rishikon dhe sistemon materialet që arrijnë në adresë të KQZ-së, dhe sipas nevojës i dërgon në adresa të caktuara;
4. Mirëmban dhe azhuron raportet, korrespondencën dhe materialet e tjera relevante;
5. Bën përgatitjen teknike të mbledhjeve të KQZ-së;
6. Detyra dhe përgjegjësi të tjera që i caktohen nga mbikëqyrësi;

Kualifikimi, aftësitë dhe përvoja e punës:

1. Diplomë Universitare;
2. Dy (2) vite përvojë pune;
3. Integritet të lartë personal dhe profesional;
4. Shkathtësi të shkëlqyera në komunikim me gojë dhe me shkrim në gjuhët zyrtare;
5. Aftësi dhe gatishmëri për të punuar në mënyrë të paanshme dhe me njerëz të përkatësive të ndryshme etnike;
6. Njohja e gjuhës tjetër zyrtare e dëshirueshme;
7. Njohje e gjuhës angleze me gojë dhe me shkrim e dëshirueshme;
8. Njohje të teknologjisë informative (MS Word, MS Excel dhe MS Access).

Procedura e konkurimit

Formulet për punësim mund të merren në zyrën e personelit apo në webfaqen e KQZ-së, në linkun www.kqz-ks.org. *Formularët për punësim dorëzohen brenda afatit të përcaktuar me konkurs, në zyrën e personelit në SKQZ, Rruga "Migjeni, nr. 21. 10000 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, përmes postës me anë të shërbimit postar.*

Formularit për punësim i bashkëngjiten kopjet e dokumenteve të nevojshme personale dhe dëshmitë për kualifikim, përvojë të punës, trajnimet e ndjekura dhe, Certifikatë (dëshminë) që s'është nën hetime.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe inkurajon aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, si dhe pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë, përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e pakompletuara refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listë të ngushtë do të kontaktohen.

Afati i aplikimit është i hapur tetë (8) ditë nga dita e publikimit, nga data 25.04.2019 deri me 02.05.2019.

Për informata shtese ju lutem kontaktoni në numrin e telefonit 038-200-23-557.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Na osnovu člana 12, stav 4 Zakona br. 03 / L-149 o civilnoj službi Republike Kosovo, na osnovu Zakona br. 04 / L-077 o obaveznim odnosima, Sekretarijat Centralne izborne komisije:

Objavljuje javni konkurs o Sporazumu za posebne usluge

1. Naziv institucije:	Centralna izborna komisija
2. Naziv radnog mesta:	Izvršni asistent Predsednika CIK-a
3. Referentni broj:	KQZ-10/2019
5. Stepenn radnog mesta:	NA – G8 / K – 12
6. Vrsta ugovora :	Šest (6) meseci
9. Izveštava kod:	Predsednik CIK-a
10. Lokacija:	Priština

Zadatci i odgovornosti:

1. Organizuje sastanke Predsednika/ce CIK-a;
2. Prosledjuje administrativna pitanja koja se odnose na efikasno funkcionisanje kancelarije Predsednika CIK-a.
3. U ime predsednika/ce CIK-a, prihvata, razmatra i sistematizuje materijal koji stize na adresu CIK-a, a ako je potrebno šalje ga na određenu adresu;
4. Održava i ažurira izveštaje, prepisku i druge relevantne materijale;
5. Vršiti tehničku pripremu sastanaka CIK-a;
6. Obavlja ostale dužnosti i odgovornosti koje su mu dodeljene od strane nadzornika;

Kvalifikacije, veštine i radno iskustvo:

1. Univerzitetska diploma;
2. Dve (2) godine radnog iskustva;
3. Visok lični i profesionalni integritet;
4. Odlične veštine usmene i pismene komunikacije na službenim jezicima;
5. Sposobnost i spremnost da radi nepristrasno i sa ljudima različitog etničkog porekla;
6. Poznavanje drugog službenog jezika je poželjno;
7. Usmeno i pismeno poznavanje engleskog jezika je poželjno;
8. Poznavanje informativne tehnologije (MS Word, MS Excel i MS Access).

Postupak nadmetanja

Obrasci za zapošljavanje mogu se preuzeti u kadrovskoj kancelariji ili na web stranici CIK-a na linku www.kqz-ks.org. *Obrasci za zapošljavanje podnose se unutar roka određenog konkursom, u Kadrovskoj kancelariji u SCIK-u, ulica "Migjeni" br. 21. 10000 Priština, svakog radnog dana od 08:00 - 16:00, putem pošte koristeći poštanske usluga.*

Obrascu za zapošljavanje prilažu se i kopije neophodnih ličnih dokumenata i dokazi o kvalifikaciji, radnom iskustvu, pohađanju obuka i Potvrda (dokaz) da nije pod istragom.

Centralna izborna komisija pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i podstiče prijave svih osoba muškog i ženskog pola, kao i članova svih zajednica na Kosovu, uključujući i osobe sa ograničenim sposobnostima.

Prijave dostavljene nakon predviđenog roka i nepotpune prijave neće biti prihvaćene.

Samo kandidati izabrani u užu krug će biti kontaktirani.

Rok za prijavu je otvoren osam (8) dana od dana objavljivanja, od 25.04.2019. do 02.05.2019.

Za dodatne informacije kontaktirajte broj telefona 038-200-23-557.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetske Bolničke i Kliniçe Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova –
University Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit



Në bazë të nenit 8 pika 1 dhe 2 e të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212; Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik; Nenit 6 paragraf 1.1, nenit 13 paragrafi 1 dhe 3, nenit 10 paragrafi 1 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK); Nenit 62 të Ligjit për Shëndetësi Nr. 04/L-125; nenit 10 paragrafi 1.1.2 dhe nenit 13 pika 1 të Statutit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës; nenit 5, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores mbi Marrëdhënien e Punës nr. 1003/2016; dhe kërkesës të datës 18.03.2019, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së publikon:

KONKURS

Institucioni:	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
Departamenti:	Sektori i Administratës së QKUK-së,
Norma e punës:	Orari i plotë,
Kontrata:	Sipas legjislacionit në fuqi
Titulli i vendit të punës:	Punëtor Administrativ – pranim-lëshim në Klinikën e ORI-së (1 pozitë),
I Raporton:	Udhëheqësit të drejtpërdrejtë,
Kategoria funksionale/Grada	5.4.
Nr. i Referencës:	QKUK- 15/2019-04/1

Titulli i punës: Punëtor Administrativ për hapjen-mbylljen e Historive të sëmundjeve dhe mirëmbajtjen e tyre.

Qëllimi kryesor i vendit të punës

- Të sigurojë dhe shënojë të dhëna të sakta mbi pacientin dhe hapjen e historive.

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Të marrë pacientin nga pranimi.
- Të regjistrojë në librin e pranimit.
- Të sigurojë dhe shënojë të dhëna të sakta dhe pastaj të bëjë hapjen e historisë.
- Të dërgojë pacientin në garderojë.
- Të drejtojë pacientin te kryeinfermierja e repartit me të gjitha të dhënat e sakta.
- Të sigurojë komunikim të mirë gjatë pranimit dhe dorëzimit të pacientit dhe nëse pala apo pacienti kërkon shpjegime të jep informata të sakta.
- Të bëjë regjistrimin e historive me rastin e lëshimit të pacientit.
- Të bëjë evidentimin e ditëve të qëndrimit të pacientëve.
- Të informojë Kryeinfermierin e Klinikës për numrin e pranimeve dhe lëshimeve gjatë ditës.
- Kryen edhe punë të tjera sipas urdhrat të mbikëqyrësit.

Njohuria, shkathtësitë, aftësitë, kualifikimi dhe përvoja e kërkuar:

- Të njohë punën me kompjuter (e nevojshme).
- Aftësi për të punuar pa mbikëqyrje,
- Te ketë aftësi komunikuese,
- Të jetë i motivuar për punë.

Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale, bazuar në specifikat e institucionit :

1. Diplomë: Shkolla e mesme (jo mjekësore);
2. Të ketë shkathtësi për të krijuar marrëdhënie të mira ndërpersonale;
3. Aftësi për të ndihmuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët;
4. Të ketë shkathtësi të krijimit të sistemit të raportimit,
5. Njohja e gjuhëve zyrtare në përdorim e dëshirueshme,
6. Certifikatën e lindjes,
7. Letërnjoftimi, fotokopje.

Dokumentacioni i bashkangjitur këtij aplikimi nuk kthehet.

Originalin e këtyre dokumenteve ose të vërtetuara të noteri do të kërkohe vetëm atëherë kur kandidati thirret për punë.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, sipas konkursit në fjalë.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar për këtë pozitë.

Konkursi është i shpallur 15 ditë nga dita e shpalljes në një nga mjetet e shkruara elektronike.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e Sektorit të Personelit në QKUK (Objekti i ri i Administratës). Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës. Kontaktet me telefon mund t'i bëni në 038/512-667

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Kandidatët të cilët aplikojnë të ofrojnë dëshmi sipas konkursit të shpallur, për ndryshe kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të thirren për intervistim.

Çdo kandidatë që aplikojnë dhe i plotësojnë kushtet sipas konkursit do t'i nënshtrohet testit më shkrim prej 100 poenëve. Kandidatët të cilët kalojnë 50 % të testit, fitojnë të drejtën të thirrjen për intervistim me gojë.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetske Bolničke i Kliniçe Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova –
University Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit



Prema članu 8 Zakona, tačka 1 i 2 o radu br. 03/L-212; Administrativno Uputstvo (MRSZ) br. 07/2017 o Regulisanje Procedura Konkursa na Javnom Sektoru; člana 6. tačka 1 i 1, član 13 i 10 tačka 1 Statuta Bolničke Službe i Univerzitetskog Kliničkog Centra Kosova (UBKSK); član 62, Zakona br. 04/L-125, o Zdravstvo, Član 10 tačka 1.1.2 i Član 13, tačka 1 Statuta Univerzitetski Klinicki Centar Kosova; Član 5 tačka 1 i 2, Uredbe o radnim odnosima br. 1003 datum 21.07.2016; i Zahtev dana 18.03.2019, Generalni Direktor UBKSK, objavljuje:

KONKURS

Institucija:	Univerzitetski Klinički Centar Kosova
Sektor:	Sektor Administracije UCCK-a,
Radna stopa:	Puni raspored,
Ugovor:	P
Naziv posla:	Administrativni radnik - prihvatanje – propust u Oftalmološkoj Klinici (1 pozicija),
Raportuje kod:	Dircknog šefu,
Funkcionalna kategorija /	Grad 5.4.
Br. Referenca:	UKCK- 15/2019-04/1

Naziv posla: Administrativni radnici za otvaranje i zatvaranje istorije bolesti i njihovo održavanje.

Glavni cilj posla

- Obezbediti i snimati tačne podatke o pacijentu i istoriju istorije.

Glavne dužnosti i odgovornosti:

- Uzmite pacijenta iz prijema,
- Zapisati u knjižici za prijem,
- Obezbediti i snimati tačne podatke, a zatim otvoriti historiju,
- Pošaljite pacijenta u garderobu,
- Vodite pacijenta na glavnu medicinsku sestru sa svim tačnim informacijama,
- Osigurati dobru komunikaciju tokom prihvatanja i isporuke pacijenta i ako stranka ili pacijent zahtijeva objašnjenja za pružanje tačnih informacija,
- Registrujte historije kada se pacijent pusti.
- Identifikovati dane boravka pacijenata.
- Obavijestiti glavnu medicinsku sestru klinike o broju prijema i propusta tokom dana.
- Obavlja druge poslove prema nalogu nadzornika.

Znanje, veštine, kvalifikacije i iskustvo:

- Prepoznati rad kompjutera (potrebno).
- Sposobnost rada bez nadzora,
- Imaju komunikacijske veštine,
- Budite motivisani za rad.

Kvalifikacija, iskustvo, veštine i lične karakteristike, na osnovu specifičnosti institucije:

1. Step: Srednja škola (ne medicinski smer);
2. Imati veštine za uspostavljanje dobrih međuljudskih odnosa;
3. Sposobnost da pomogne i saraduje sa drugima;
4. Imaju mogućnost da naprave sistem izveštavanja,
5. Poznavanje zvaničnih jezika u poželjnoj upotrebi,
6. Izvod rođenja, fotokopija,
7. Lična karta, fotokopija.

Dokumentacija priložena ovoj aplikaciji se ne vraća.

Original ovih dokumenata ili atestiranih notara će biti potreban samo kada se kandidat pozove na posao.

Uslovi učešća u zapošljavanju: Pravo prijave su svi državljani Republike Kosova odraslih koji imaju potpunu poslovnu sposobnost, u skladu sa konkursu u pitanju.

Takmičarski postupci: Konkurs je otvoren za sve kandidate zainteresirane za ovu poziciju.

Konkurs se objavljuje 15 dana od dana objavljivanja na jednom od elektronskih sredstava.

Prijavni zahtevi: Prijave se primaju i dostavljaju u kancelariju UKCK kadrovske službe u novoj zbradi UKCK.

Aplikacija treba jasno navesti naziv posla i referentni broj. Telefonski kontakti se mogu izvršiti na 038 / 512-667

Aplikacije koje su poslate nakon završetka konkursa i nepotpune zahteve neće biti prihvaćene.

Podnosioci zahteva pruži dokaze od strane konkursa za različite kandidate koji ne ispunjavaju uslove konkursa neće biti pozvan na razgovor.

Svaki kandidat koji se odnosi i ispunjava uslove konkursa će proći pismeni test na desetine 100. Kandidati koji polože 50% testa, zarađuju pravo da budu pozvani na usmeni intervju.

Generalnog Direktora UBKSK

Dr. Basri Sejdiu



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerziteteske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova –
University Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit



Në bazë të nenit 13 pika 3 e Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, nenit 6 pika 5.1, të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, dhe Kërkesës nr. 641/3 të datës 23.04.2019, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, nxori këtë:

V E N D I M

Për përsëritjen e Konkursit publik,

- I. Konkursi publik nr. 641, datë 29.03.2019, për Mjekë Specialistë të lëmive të ndryshme në QKUK (4 pozita), për shkak të numrit jo të mjaftueshëm të kandidatëve (aplikuesëve), vazhdohet edhe për 15 ditë nga dita e publikimit në njërin nga mjettet e informimit.
- II. Obligohet Sektori i Personelit për zbatimin e këtij Vendimi;
- III. Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Sektori i Personelit të QKUK-së pas mbylljes së konkursit publik më datë 19.04.2019 e Njofton Drejtorin e Përgjithshëm të SHSKUK-së që konkuri është mbyllë por nuk ka pasur kandidatë të mjaftueshëm për pozitën e shpallura dhe kërkon që konkursi të vazhdohet sipas nenit 6, pika 5.1 e Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, edhe 15 ditë.

Prandaj, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, në bazë të kompetencave, konform ligjit në fuqi dhe Kërkesës në fjalë, lejon përsëritjen e Konkursit publik si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

VENDIMI T'I DORËZOHET
✓ Zyrës së personelit,
✓ Një mediumit informativ.
✓ Arkivit.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se shoqëria » AR – D. Invest « SH.P.K., me seli në Prizren, rruga: EDIT DURHAM, NR:167., ka marrë vendim që ta shuaj Shoqërinë me NRB. dhe NRF. 810135120 me likuidim vullnetar dhe e ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e prodecurës së likuidimit vullnetar.

I njoftojmë të gjithë klientët që kanë raporte kreditore-debitore me këtë shoqëri që të paraqiten në afatin prej 30 ditësh nga data e shpalljes së likuidimit vullnetarë në gazetë.

O B A V E Š T E N J E

Obaveštavamo sve kliente da društvo » AR – D. Invest « D.o.o., sa sedištem u Prizrenu, ulica: EDIT DURHAM, BR.:167., doneo je odluku o gašenju biznisa sa REG.Br. i FBR. 810135120 putem dobrovolne likuidacije i ujedno imenovao likuidatora o vodjenju postupka dobrovoljne likuidacije.

Obaveštavaju se svi klienti koji imaju potraživanja i obaveze u navedenom društvu, da se jave u roku od 30 dana od dana oglašavanja dobrovoljne likuidacije u novini.

A N N O U N C E M E N T

We inform all clients that the company » AR – D. Invest « L.L.C., based in Prizren, the road: EDIT DURHAM, NR, 167, has taken the decision to cancel the company with Busines and Fiscal No. 810135120 and with voluntary liquidation and has appointed a liquidator for the development of voluntary liquidation proceeds.

We notify all clients that have credit - debit reports with this company to appear within 30 days from the date of announcement of voluntary liquidation in the newspaper.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerziteteske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova –
University Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit



Na osnovu člana 13, stav 3 Statuta Službe Bolnice i Kliničke Univerzitetske Kosova, član 6 tačka 5.1. Administrativno uputstvo (MRSZ) br. 07/2017 o Regulisanju Procedura Javnog Konkursa i Zahtevu br. 641/3 od 23.04.2019, Generalni Direktor UBKSK je izdao:

O D L U K A

Za ponavljanje javnog konkursa,

- I. Javni konkurs br. 641, od 29.03.2019, za Lekare Specijaliste različitih oblasti u UKCK (4 pozicije) zbog nedovoljnog broja kandidata (aplikanata), nastavlja se 15 dana od dana objavljivanja u jednom od sredstava informisanja.
- II. Sektor za osoblje je obavezan da sprovede ovu Odluku;
- III. Odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

O b r a z l o Ź e n j e

Sektor za kadrovske poslove UKCK-a nakon zatvaranja Javnog konkursa 19.04.2019 objavljuje Generalnog Direktora UBKSK-a da je konkurs zatvoren, ali nije imao dovoljno kandidata za objavljena konkursa i traži da se konkurs nastavi prema članu 6, tačka 5.1 Administrativnog uputstva (MRSZ) br. 07/2017 o regulisanju postupka javnog konkursa, još 15 dana.

Prema tome, Generalni Direktor UBKSK, u skladu sa nadležnostima, i sa važećim zakonom i predmetnom Zahteva, dozvoljava ponavljanje javnog konkursa kao u dispozitivu na ovu odluku.

Kao što je već navedeno, odlučeno je kao u dispozitivu ove odluke.

ODLUKA KOJI SE PODNOSI
* Kancelarija za kadrove,
* Informacioni medij.
* Arhiva.

Generalni Direktor UBKSK.

Dr. Basri Sejdiu

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se shoqëria » GENIS SOFT « SH.P.K., me seli në Prizren, rruga: BULEVARDI I RINISË, PN., ka marrë vendim që ta shuaj Shoqërinë me NRB. dhe NRF. 810075798 me likuidim vullnetar dhe e ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e prodecurës së likuidimit vullnetar.

I njoftojmë të gjithë klientët që kanë raporte kreditore-debitore me këtë shoqëri që të paraqiten në afatin prej 30 ditësh nga data e shpalljes së likuidimit vullnetarë në gazetë.

O B A V E Š T E N J E

Obaveštavamo sve kliente da društvo » TIK.COM « D.o.o., sa sedištem u Prizrenu, ulica: BULEVARDI I RINISË, bb., doneo je odluku o gašenju biznisa sa REG.Br. i FBR. 810075798 putem dobrovolne likuidacije i ujedno imenovao likuidatora o vodjenju postupka dobrovoljne likuidacije.

Obaveštavaju se svi klienti koji imaju potraživanja i obaveze u navedenom društvu, da se jave u roku od 30 dana od dana oglašavanja dobrovoljne likuidacije u novini.

A N N O U N C E M E N T

We inform all clients that the company » TIK.COM « L.L.C., based in Prizren, the road: BULEVARDI I RINISË, No. number, has taken the decision to cancel the company with Busines and Fiscal No. 810075798 and with voluntary liquidation and has appointed a liquidator for the development of voluntary liquidation proceeds.

We notify all clients that have credit - debit reports with this company to appear within 30 days from the date of announcement of voluntary liquidation in the newspaper.

Sot me 25 prill 2019 bëhen 29 vjet nga ndarja fizike e Vëllaut tonë

Fadil (Nebih) VATA

(03.01.1962 - 25.04.1990)
(Hero i Kosovës)

I ri me moshë mirëpo i pavdekshëm me vepra. Vepra jote atdhetare ishin shembull frymëzimi për të gjithë ata që luftuan për lirinë e Kosovës. Për gjeneratat e ardhshme jeni shembull i idealistit, guximtarit dhe dijetarit, që nuk kurseu asgjë në të mirë të Atdheut. Jemi krenarë që të kemi udhërrëfyes në jetën tonë, për të jetuar dhe punuar me nderë për Atdhe.

Me mall dhe krenari: vëllezërit Rama dhe Florimi, motrat Mehremja, Vezirja, Merita dhe Kastriotja, kunatat Imranja dhe Sabrija, nipat Atdheu, Arbëri, Fadili dhe mbesa Urata.



RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

Prishtinë

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Arda Butuci shpall te pavlefshme deftesat e kl VI - IX shf " Emin Duraku " Prizren

► Driton Qeriqi shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shf " Emin Duraku " Prizren

► Isak Gegollaj shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shf " Bajram Curi " Lubizhd e Hasit

► Islam Zekaj shpall te pavlefshme deftesat e kl VI - IX shfmu " Bajram Curi " Romaje

► Ardian Bytyqi nga Suhareka, shpall të pavlefshme Licencën e Punës.

► Basri Sali Ibrahim shpall të pavlefshëm diplomën e Fakultetit Juridik të lëshuar gjatë vitit 1995 nga Universiteti i Prishtinës.

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 bane-sa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.

► Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Tel. 044-413-197, viber: 045-198-095.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/giejpuneshpejte